

*"Burimi i vërtetë i të drejtave tona është detyra" - GANDI*



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 138, prill 2015**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## MANIFESTIMI TRADICIONAL "ZËRI I VËLLAZËRISË-2015", NË 15 VJETORIN E THEMELIMIT TË SHOQATËS "MARTIN DRESHAJ"...

**Reportazh...**

Në kuadër të 15 vjetorit të themelimit të shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me 12-13 prill 2015, u zhvillua manifestimi tradicional "Zari i Vëllazërisë-2015". Nuk kishte si të mungonte me pjesëmarrjen, por edhe me prezantimin e saj mjaft të mire, Shoqata "Atdhetare- Dukagjini", ajo që për shumë vite me rrallë i jep tonin këtij spektakli kulturor.

Mjaft të ngarkuar me angazhimet e punës, por edhe me përgatitjet PR vendosjen e shtatoreve të luftëtarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj, një pjesë e anëtarëve të kryesisë e kishin të pamundur pjesëmarrjen....

Falë këmbënguljes të kryetarit, por edhe mbështetjes të mundësorëve, një grup prej 25 vete, drejtues dhe aktivist të shoqatës, valltarë, këngëtarë dhe artistë, përfaqësuan denjësisht Dukagjinin, Shkodrën në këtë manifestim të përvitshëm. Udhëtimi do të fillonte në mëngjesin e së dielës herët. Autobusi komod, me dekor mjaft bukur dhe i drejtuar me kujdes nga shoferi me përvojë, Halimi Halili, do ta linte Shkodrën rreth orës 07.00 të mëngjesit...



6

### ZEF MALA, MES LAVDISË DHE PERSEKUTIMIT 100 VJETORI I LINDJES (14 PRILL, 1915-2015)

*"Meritat dhe mbrojtjen time ia kam besue Historisë së nesërme" ...*

Janë të rrallë personalitet të cilet njëherazi janë të persekutuar (burgime, internime, i vdekur në burg-një tmerr pa fund) por dhe të lavdishëm për vlerat; si intelektual, si drejtues politik e shoqëror, në një vend të vogël si Shqipëria. Për ata që nuk e njohin, Zef Malen, ose ata që e njohin disi ndryshe sipas të pavertetave në Historinë e PPSH, mund të themi se është një nga figurat më të jashtëzakonshme të politikës - përfaqësues i majtës shqiptare.



3

### Një stemë heraldike antike dhe dinjitoze për Shkodrën!

11

AGRON LUKA

Botimi më i fundit, i sistemit monetar mesjetar dalmatin, të qyteteve të shekullit XIV e XV, ku inkuadrohet edhe Shkodra me monedhat e saj autonome, sinjalizimi i gjetjes së një ekzemplari të një monedhe shkodrane në Drisht...



### Kadri Ujkaj - Pena e "Qytetit pa reklama" - REFLËKSIONË RRETH LIBRIT TË TIJ "KRIZA SI DEHJA NGA ENTUZIAZMI MODERN!" -

Trajtimi i temave me përmbajtje të thellë filozofike e psikologjike, që kanë të bëjnë me ndjenjën, shpirtin, jetën dhe fenomenet e mendimit njerëzor, tek indiferenca e kalimtarëve të zakonshëm ekziston mendimi se këto janë pronë e penave që kanë emër të madh në letërsi e art. Pronë e njerëzve që priten nëpër sallone me tapete të trashë e të butë, nën dritën e bliveve, kamerave, gazetarëve, pritjeve elitare dhe pompoze, të cilëve u shkon për shtat modeli i këmishës së politikës dhe zyrtarizmit. Se vetëm ata dinë ta trajtojnë dhomën e errët të gjumit, me dhe pa perde, të lakuriqësishë, në dritën e zbehtë të intimitetit të epsheve, të cilat shfryhen si në vargun migjenian...apo dhe trajtesave që kanë një ngarkesë të intelektualëve dhe akademike, që hyjnë deri në labirinte, shpesh, në dukje të paarritshme.

4

## HUJE QË NUK VDESIN SATIRË DHE DHIMBJE



LAZER KODRA

*Vetë më fale more Zot  
Që në jetë të jem njeri  
Po m'dhunove me idiot  
Nuk besoj atë as ty!*

Po... ishim të mahnitur atë ditë! Rrokëm fshesat ndër duar, shtupat vringëlluan mbi sipërfaqet e pista të xhamave, nga supet shkundem zbokthin, që jo pak na mundon në këto ditë pranvere dhe ... pritem derisa na u shfaqet ju. Ju që

e kishit çuar lajmin me kohe për gjoja një ligjëratë fine në foltoren e viganosur nga delitizmi idiotesk, që ka pushuar gjithandej në mbretërinë e fasadave. ...Dhe, ja.. mbër-rite he burri vocërrak i dheut të vjetër! Ngjasojë me përfaqësuesin e mbretërisë së brumbujve, ose më së shumti me atë të xhuxhmaxhuxhëve. I stërkequr nga mundi për t'u dukur mirë e potent, gjasme edhe si pushtetarë potencial, kishe perfunduar në një qenie skenike të përshtatshme për rolin me komik që mund të luhet brenda kohës sonë, që ka perfunduar vetë në një komizëm të vërtetë. U ngjite në podium, "O MADHËRI!", gjithë delikatesë... dhe prite pastaj ligjëratën tënde sugjестive sa na bëre të kujtojmë shprehjen e Shekspir-it të madh "O turp, ku e ke skuqjen?!!!" Ndërsa dife-

rencen e bëmë duke të krahasuar me fjalimin e Martin Luter Kingut apo Letrën e Kryeparit të Indisë nga Siatëlli! Nuk kishte shumë diferencë! Thuajse ... sa toka me dielin. Janë kohë moderne këto more burri i vogëli i dheut të vjetër! I kishe mber (dh i e r) thyer fjalitë në një sintakse "të goditur" që përlligj më së miri kreativitetin tënd logjik, intelektin tënd profan, tashmë të njohur nga të gjithë! Po bie fjala, ia filloje të flisje për kometën Hallej e të dilte mizë në pjatën e groshës; ia filloje të flisje për kibernetikën e të dilte fije spangoje e lidhur në dy kutia shkrepshash, siç luanim dikur; ia filloje të flisje për bashkëkohësi dhe rrëshqisje në humnerat e zeza të mesjetës; ia filloje të flisje, me seriozitet, për institucionin të cilin e njihje si gomari matematikën dhe të dilte thirrja: Loordes! Po të ishte aty pran teje një vajticë patjetër do ta motivoje për vargjet: "Të lumtë goja karabush / Ligjëratë si ti askush / Lum

fisi që t'ka / Lum fshati që t'zgjodh / Historikisht idioti / Vetëm idiot polli!" Po nuk u mjaftove me kaq more i deleguari i djallit! Andej nga fundi e nxore shpatën nga milli dhe fillove të godisje në tabela imagjinare, pasi ato nuk ishin aty! O çfarë talenti kishe në betejat me njerëzit në mungesë!!! U kënaqem Pasha Zotin! E si mos të kënaqemi kur një Don Kishot demonstroi forcën në kohët tona moderne, ndërkohe që Sançua, bashkë me gomarin e tij (Rosinantin), e priste jashtë për t'i rrëfyer arritjet e kësaj beteje kaq të furishme. Thonë, se në çdo tragjedi ka edhe një mrekulli. Mrekullia ishte, se ne shpëtuam ... falë Zotit! Atë natë, thuajse të gjithë, kishim parë dy ëndrra thuajse të njëjta. E di se të ha meraku që t'i dish. Hajt, për hatrin tënd do t'i tregoj, megjithëse ti ishe aty, por nuk e ke parë veten! E para: Në stomin e një oborri të mbushur plot pleh kishte mbirë një kungull. Ishte plot shëndet dhe çdo ditë shtonte

edhe lozët vegjetative dhe po çdo ditë shtohet një kungull, ose një kungulleshë. Rriteshin shpejt dhe thuajse brenda pak kohe, po u vazhdua kështu, gjithë toka, plot me vlagë, do të mbushet me kunguj, E dyta: Brenda një vathi disa kuaj hingëllin pa pushim. U pëlqente vrapimi, por në të katër anët kishin ngritur mure të larta ... të larta ... të larta! Të shkretët kuaj nuk kishin nga t'ia mbathnin vrapit. Dhe jo vetëm kaq ... por edhe aty të izoluar nuk i linin rehat, pasi çdonjërit, aty tek vrima anale, i ishte ngjitur një bubajke e cila edhe i pinte gjakun edhe i hante (m ...) bajgën! Hajt ... ta lëmë tani, se po të lavdërova përsëri, druhemi se mos na vjen prapë! Më fal! Po dua të ta kujtoj një shprehje latine: O TEMPORA, O MORES! Don të ta përkthej në shqip? Po, në shqip do të thotë: O KOHË, O MORAL! Për domethënien pyet mbretërinë, në emër së cilës ligjërova.

## SHKODERA PARARENDSA NE ZHVILLIMIN E ARSIMIT SHQIPTAR



Mark Bregu

Dita e mesuesit, me zgjoj kujtesen që te evidentoj figurat me te lavdishme te nacionalitetit tone, që kontribuan për hapjen e arsimit dhe te dijes ne kohen ma te veshtire qe kalonte atdheu yne nen pushtimin Osman, dhe nen metodaat byzantine te sistemit mashtrues-Xhon Turk. Per te materializue me fakte konkrete kete shkrim modest, mendova t'i referohem librit plot vlere te Profesorit te shquem shkodrane, Vehbi Hotit: Profesi I nderuem na e ka dhane ne menyre te detajueme, dhe me shum vertetesi kontributin teper

te vlefshem te intelgjences dhe patriotizmit shkodrane, ku shkelqen me te gjithe madheshtine figura e Mesuesit dhe Heroi te Popullit, Luigj Gurakuqi, e Poetit t'one kombetar At' Gjergj Fishtes, e Mjedes, Logorecit e te tjere.

Kongresi i Manastirit asht evenimenti ma madhor ku, shkelqen prania e Fishtes dhe e Gurakuqit (kryetar e sekretar) te komisionit per ndertimin e alfabetit te gjuhes shqipe. Asht teper episodice dhe donmethanes moment kur At' Gjergj Fishta perfundon ligjeraten, nga e cila perloten te gjithe dhe, atdhetari i shquem, Hafiz Ali Korca e perfaqeson Fishten. A ka akt ma te madh dhe ma sublime qe, krishterimin dhe islamizmin i "shkrine" ne nje "solucion" te vetem, ne ate shqiptare? Komisioni i alfabetit ne Kongresin e Manastirit ishte gjith perfshires. Aty banin pjese njembdhjete anetare: 1) Gjergj Fishta-Kryetar; 2) Mit'hat Frasheri-Nenkryetar; 3) Luigj Gurakuqi-Sekretar, 4) Gjergj Qiriaz, 5) Ndre Mjeda, 6) Grigor Çilka, 7) Dhimiter Buda, 8) Shahin Kolonja, 9) Sotir Peci, 10) Bajo Topulli, 11) Nyzret Vrioni. Pra, sic shihet kemi nje perfshirje, por gjithsesi, Shkodra perfaqesohet me tri figura

te shqueme: Gjergj Fishta (Kryetar), Luigj Gurakuqi (sekretar) dhe Ndre Mjeda (anetar). Nuk eshte aspak rastesi kjo paraprirje. Jane prodhim i kesaj kryeqendre te arsimit dhe te cultures Barleti dhe Bicikkemi, Buzuku dhe bardhi, per te ardhur pastaj te guzulloret dhe te folkloristi i madh, Zef Jubani. Kontriboret shkodrane per arsimin jane te shumte dhe teper cilesore, ku shkelqen me te gjithe madheshtine, i pavdekshmi dhe i paperseritshmi, Mesuesi dhe Heroi i Popullit Luigj Gurakuqi. Personaliteti i Gurakuqit merr permasa gjigande sidomos ne vitet 1916-1917, kur drejton me plote kompetence dhe dinjitet "Komesine Letrare"! Ishte koha e pushtimit austrohungarez (1916-1918). Me inisiativen e Luigj Gurakuqit, si Drejtor i Drejtorise se Pergjithshme te Arsimit, me 1 shtator 1916 fillon punen ne Shkoder "komsia Letrare Shqipe". Ajo perfaqesonte, ne vetvehte, nje komision gjuhetaresh te krijuar me qellim qe te conte me tej zgjidhjen e problemeve te gjuhes se njesuar shqipe pas Kongresit te Manastirit. Komsia grumbulloi nje grup intelektualesh nga ma te njohurit e vendit. "Eksperte te te gjitha fushave, njohes te te gjitha gjuheve klasike e modern te kontinentit Evropian, si dhe te zhvillimit arsimor e kulturor te

vendeve te perparuara", (prof. V. Hoti).

Luigj Gurakuqi ishte figura qendrore organiozuese e drejtuese e ketij komisioni, ishte shpirti i tij. Per kete flasin disa fakte, te cilat na i ka dhane ne menyre te detajueme,. Prof. Vehbi Hoti, ne librin e tij plote vlere: "Luigj Gurakuqi". Per shkollen shqipe dhe arsimin kombetar.

Dhe faktet flasin:

Te dhanat e shtypit dhe te botimeve te ndryshme e pohojne nje gja te tille. E gjithë puna perqatitore, diskutimet per statutin, rregulloren dhe menyren e zhvillimit te punes e realizimin e programit u bane ne zyren e Drejtorise se Pergjithshme te Arsimit, nen drejtimin e Gurakuqit. Ne botimin special kushtue Gjergj Fishtes, me 1941, thuhet se "... ne qeverine austrohungareze, çeshtja e gjuhes shqipe qe pika kryesore e programit te Drejtorise se Pergjithshme t' Arsimit nen drejtimin e Gurakuqit, ma te vlefshmit atdhetar. Ky u vu ne perpjekje bashke me At' Gjergj Fishten dhe bashkarisht perputhen mendimin e me pelqimin e komandes eprore ushtarake u formue ne gji te Arsimit "Komsia Letrare" (1916). Ai ka meriten se vleresoi drejt problemin e gjuhes se njesuar dhe ngritjen e shkollës shqipe, si element baze te krijimit te cul-

tures kombetare. Ai ka lane nje trashegim pedagogjik dhe nje pervoje teorike e praktike me karakter dhe permbajtje kombetare, me fryme perparimtare e demokratike.

Ma mire e ma qarte se cdo paraardhes i tij, formuloi konceptet themelore mbi edukimin e mesimin, trajtoi me kulture shkencore e pedagogjike faktoret e zhvillimit te personalitetit njerezor, vlereoi shum rrolin e educates e te shkollës, te familjes e te trashegimise dhe te mjedisit ne kete process, shtriu domosdosherine e edukimit qe ne moshat e njoma ... (Nje leksion mjaft i vlefshem ne stadin actual qe po kalon familja shqiptare ... M. B.), vlen te kujtojmë dhe vepren teper te vlefshme te prof. Ernest Koliqit, kur drejtonte arsimin shqiptar. Ai dha nji kontribut shum te madh, duke dergue ne Kosove 200 mesues e mesuese, dhe duke hapur tri gimnaze, ne Prizren, ne Peje dhe ne Gjakove, si dhe nje shkolle te mesme bujqesore ne Tetove.

Kto jane kualitete cilesore te arsimit dhe te cultures qe Shkodra ja dhuroi atdheut. Shembulli i tyne duhet te ndiqet nga brezat e ardhshem. Keta jane krenaria e Shkodres dhe mbare Shqipnise.

# ZEF MALA, MES LAVDISË DHE PERSEKUTIMIT

## 100 VJETORI I LINDJES (14 PRILL, 1915-2015)

**"Meritat dhe mbrojtjen time ia kam besue Historisë së nesërme" ...**

Janë të rrallë personalitetet të cilet njëherazi janë të persekutuar (burgime, internime, i vdekur në burg-një tmerr pa fund) por dhe të lavdishëm për vlerat; si intelektual, si drejtues politik e shoqëror, në një vend të vogël si Shqipëria. Për ata që nuk e njohin, Zef Malen, ose ata që e njohin disi ndryshe sipas të pavartetave në Historinë e PPSH, mund të themi se është një nga figurat më të jashtëzakonshme të politikës - përfaqësues i së majtës shqiptare.

Është ky 100-vjetori i lindjes që mund të themi dicka më shumë dhe të sjellim në vëmendje Zef Malen. Në këto njëzet e pesë vitet e fundit, pas vendosjes demokracisë, për dhjetëra personalitete shqiptare të fushave të ndryshme, të vdekur apo që jetojnë, janë bërë me qindra shkrime e vlerësime, janë dhënë me dhjetëra tituj nderi, dekorata dhe dëshmipërblime, për persekutimin e tyre nga regjimi komunist. Sigurisht ky është një detyrim historik e ligjor i shoqërisë duhet të bëhet në vlerësim të kontributit dhe të sakrificave të tyre deri në flajim. E rëndësishmja është të njihen vlerat dhe meritat reale të persekutuarve politik, personalitetet të vlerësohen sa me realisht. Po kaq e rëndësishme është, të mos harrohën disa personalitete të tjera që ndoshta nuk ka palë të interesuara politike direkte, familjar dhe të afërm që të nxisin apo si thonë

të "sponsorizojnë" në njohjen dhe evidencimin e vlerave dhe kontributeve të tyre. Mbetet shume për të bërë, vecohet njëri, të cilit, historianet, mendimi politik e filozofik shqiptar dhe qeverisja e kohës, që vazhdojnë "ti mbeten borxh është Zef Mala". Te ky personalitet mund të themi se ishin të mishëruara: filozofi e politikani, historiani e shkrimtari, juristi e ekonomisti, esteti e gazetari; ndoshta një njeri unik i trojeve shqipfolëse. A jemi sot në ditët e së nesërme të Zef Males që ai besoj njohjen e meritave dhe mbrojtjen e tij?! A jemi para një amaneti të pambajtur, a duhet të vinë ditë të tjera dhe sa kohë duhet të kalojë që Zef Mala të ketë vlerësimin dhe vendin e nderuar që meriton. Ndonë se ai themeloi e drejtojoi njerin nder grupet komuniste më të rëndësishme në vend, ai nuk u ftua në themelimin e PKSH, pra asnjë dite ai nuk qe antar i PKSH. Që në ditët e para të jetës së PKSH, do të ishte kundërshtar i hapur i veprimtarisë së sajë të drejtuar nga Enver Hoxha. Ai u dënua e u persekutua, pasi hapur me fakte dhe argumente, kritikoj Enver Hoxhën, regjimin dhe qeverisjen e tij, regresin që i

solli Shqipërisë, duke larguar nga gjiri i Evropës dhe i demokracisë. Edhe pse kaluam një çerek shekulli shtet demokratik, akoma emri dhe vepra e Zef Males nuk kanë zënë një vend të merituar në shkencën albanologjike, nuk mjaftojnë ato pak gjëra që kanë synuar në publikimin dhe njohjen e vepres dhe kontributit të tij. Ndoshta për herë të parë në vitin 2000 një gazete e dites do botonte një dossier "Zef Mala e themeloi Partinë para Enver Hoxhes" (D.Kaloçi). Në vitin 2002, me kontributin e vajzave (Maria dhe Esmeralda) dhe të studjuesit L.Ndoja, kemi një botim të disa shkrimeve të Zef Males



ne titullin "Vox Populli-Zëri i Popullit". Po ne këtë botim është "Testamenti politik"-Promemorie e Zef Males drejtuar Mehmet Shehut. Në vepren "Rrno për me tregue" të ndërjetit at Zef Pëllumbit ka një përshkrim të njohjes Zef Malen, duke e vlerësuar si njërin nder intelektualët dhe personalitetet me të rëndësishëm të kohës. Në botimin e Ndrëqim Kullës (2014), "Enciklopedia Antologjike e Mendimit Shqiptar nga viti 1807 deri në vitin 1957", Zef Mala do të ishte i perzgjedhur ne këtë botim midis 25 personaliteteve të kohës, me disa shkrime publicistike të perzgjedhura nga "Vox populli". A thua mjafton kaq për të hequr të gjithë atë "baltë të hedhur nga E.Hoxha dhe kalemxhijtë afer tij", të konsideruar si; utopist, si tradhtarë dhe percares të lëvizjes komuniste, me konceptet ideologjike e politike të kufizuara, etj, e shoqëruar kjo me privim të lirisë deri me dhunim të jetës për 50 vite, sigurisht që jo. Është e udhës dhe si detyrim moral i historianëve, analistëve, politologëve dhe studiuesëve të ndryshëm; që të ndriçojnë figurën poliedrike të Zef Malës, si mendimtari i parë politik laik i drejtimit social-demokrat shqiptar,

opozitari i shekullit 20-të.

Jeta dhe veprimtaria e tij shumë dimensionale është ndoshta ndër më të spikaturat në mezheshkullin e 20-të. Në një moshë të re ndoshta me pak se 20vjeçare me shkrimet e tij që në vitin 1934 në revistën "Arbnia" më vonë në revista të tjera, do të cfaqe idetë e një iluministi social-demokrate. Shoqëria shqiptare, qysh nga vitet '30 të shekullit të kaluar e njihte Zef Malen si një nder themelesit si drejtuesin e Grupit Komunist të Shkodrës, njëri ndër grupet kryesore me veprimtari jo vetem në Shkodër por në Kosovë, Tiranë, Elbasan, Korçë, etj.

Veprimtaria e tij kishte një bazë teorike, kishte një angazhim aktiv politik dhe filozofik, për ndryshim dhe përparim të Shqipërisë. Me këtë qasje (ndryshe një lufte guerile), për më se një dekadë më një veprimtari të madhe politike, publicistike do të kundërshtonte hapur regjimin monarkist të Zogut. Me tej ai aspironte për një Shqipëri në tërësinë e Evropës, si vend të zhvilluar e demokratik.

Zef Mala, tek analizon veprimtarinë e tij thotë: "Në qoftë se në rininë time të parë, sentimentalizmi e fanatizmi djaloshar më patën shtyrë me përfaqje idetë luftarake të lëvizjes komuniste ndërkombëtare si udhën e vetme për të përmbushur aspiratat e popujve për liri barazi, drejtësi sociale e progres të përgjithshëm, pjekuria e mendimit në një moshë ma ta shtyme me studimet e mia në ndërkohë më patën privë tashma drejt një socializmi demokratik e liberal, humanist e kritik, si udhë e domosdoshme për të siguruar atë liri e drejtësi sociale pas të cilën asnjë shoqni njerëzore nuk mundet të ndërtohet e të përparojë."

Jeta në liri fizike e Zef Malës që pakët ai u denu me rreth 60 vjet burg. Ai u burgos dhe u përdoq që nga viti 1937 e deri sa nderroj jetë në burgun e Tiranës me 31 dhjetor 1979, nga tre qeveri (e Zogut, pushtuesit italian dhe qeveria e Enver Hoxhes). Edhe në periudhat jashtë burgu, ai ishte i izoluar, pra e gjithë jeta dhe veprimtaria e tij mbeti në një mbikqyrje të shtetit komunist. E si të mos mjaftonin gjith keto denime, në rrethna të ndryshme janë zhdukë dorëshkrimet, mjaft libra, studime e botime të ndryshme, të gjitha këto për të mos u njohur në thelb Zef Mala. Duke qëndruar hapur kundër regjimit komunist të Enver Hoxhes (pas viteve 50 ishin të pakët ata që mendonin dhe akoma me të paket ata që merrnin guximin të shkruanin e dilnin hapur), por me një shpresë në të ardhmen ai në testamentin politik do të shprehej: "Unë di se në Arkivat shtetërore ruhen arka me dokumente që i përkasin aktivitetëve të mia të dikurshëm, që do të dëshiroja të baheshin publike i bindur, se nuk janë të shumtë ata persona të shquem në horizontin shqiptar tash 70 vjet e këndeje që

posedojnë qoftë në jetën e tyre private e qoftë në atë politike një pastërti morale e politike të krahasueshme me atë që karakterizon jetën dhe veprën time, prandaj mbrojtjen time ia kam besue Historisë së nesërme, e cila do të më njohë meritat që më takojnë jo vetëm për sa kam ba, dhe nuk asht pak, dikur për vendin tim, por sidomos për atë që nuk kam ba, e nuk kam pranue t'i baj që nga kthimi im në atdhe e deri sot e në mënyrë të veçantë për mendimin tim se e ardhmja e Socializmit kalon nëpër udhën e lirive në realizimin e një shteti të themeluar mbi konsensin e lirinë të vullnetshëm e të gjithë shtetasve të ngritur në shkallë qytetarie e në kuadrin e një pluralizmi e opinio-nesh që janë refleksi i pluralizmit politik, social, ekonomik, kulturor e moral në të cilën merr trajtë e përmbajtje çdo shoqni njerëzore e në çdo sistem qeverimi"

Filozofia, kritika, orientimet dhe qendrimet politike të Zef Males janë aktule dhe në ditet e sotme. Këto pjese të shkëputura nga artikujt e botuar 70-80 vite më parë, për fatkeq në të shumtën e tyre duken si janë shkruar dje, pasqyrojnë këtë realitet shqiptar, këto ceshtje sot diskutohen e shtrohen për zgjidhje në jetën dhe politikën shqiptare, etj. Nga botimi "Vox populli" janë perzgjedh këto pasazhe.

**Shoqnia shqiptare** - "Kështu morali ynë shoqënor sot për sot gjendet në një gjendje tranzicioni, këndeje shpjegohet dhe moskënaqësia e ditëve tona, shregullimi në të gjitha pikpamjet e jetës shqiptare... Por me çlirimin politik dhe gjendja morale e popullit pati tronditje të thella, sepse përdhunimi që e mbante të lidhur deri atëhere u shkatërrue tue lëshue shoqërinë shqiptare në një shregull që ndërronte herë pas here, simbas duerve që merrnin në dorë frenat si drejtues të shumicës. Fati ynë solli që drejtimit e ndryshme politike të jenë shpesh herë edhe në kundërshtim në mes tyre kështu nuk qe e mundun me u konsolidue hëpërhë ajo harmoni që dikush shpresonte se do të arrihej, dhe e cila harmoni do të ishte vetëm vijimi i gjendjes së vjetër, plot korrupsion në çdo shfaqje të sajën. Por megjithate korrupsioni u zhvillue edhe ma tepër tash vonë tue arritë kulmin gjat që ndihmoi shumë për të dhanë shkasin për kërkesa të reja". Mjerimi që po qajmë përditë, në realitet qe një fat për ne, sepse mospërkimi me frymën e maparëshme ndihmoi me u zhvillue ndjenja e së resë, ndjenja e moskënaqjes me gjendjen e sotme. ...."Jeta shqiptare, meqë nuk kemi pasë kurrë një frymë krejt tonën, një ideologji që të pasqyrojë aspiratat e popullit shqiptar, të vequem si shqiptar, nuk mund të sinkronizohet me çdo rrymë tjetër, koha që jetojmë e vendi ku gjindemi, kanë nevojë për baza morale shoqënore krejt të reja që të përfaqësojnë jo të shkuemen por të ardhmen". Botue në vitin 1935.

(vijon në numrin e ardhshëm)

# Kadri Ujkaj - Pena e “Qytetit pa reklama”

- REFLEKSIONE RRETH LIBRIT TË TIJ “KRIZA SI DEHJA NGA ENTUZIAZMI MODERN!” -

Trajtimi i temave me përmbajtje të thellë filozofike e psikologjike, që kanë të bëjnë me ndjenjën, shpirtin, jetën dhe fenomenet e mendimit njerëzor, tek indifferenca e kalimtarëve të zakonshëm ekziston mendimi se këto janë pronë e penave që kanë emër të madh në letërsi e art. Pronë e njerëzve që priten nëpër sallone me tapete të trashë e të butë, nën dritën e bliceve, kamerave, gazetarëve, pritjeve elitare dhe pompoze, të cilëve u shkon për shtat modeli i këmbës së politikës dhe zyrtarizmit. Se vetëm ata dinë ta trajtojnë dhomën e errët të gjumit, me dhe pa perde, të lakuriqësisë, në dritën e zbehtë të intimitetit të epshëve, të cilat shfryhen si në vargun migjenian...apo dhe trajtesave që kanë një ngarkesë të madhe intelektuale dhe akademike, që hyjnë deri në labirinte, shpesh, në dukje të paartshme.

I gjithë ky strumbullar konceptesh dhe paragjykimesh i “thyen hundët”, para një malësori të sojshëm në trajtesën e vet në letërsi, që fisnikëria i regëtin në traun e guximit, siç është shkrimtari dhe kritiku i vlerë Kadri Ujkaj, i cili në të gjithë krijimtarinë e tij e ka hedhur farën në një bashtinë të sertë, siç është mendimi kritik në letërsi, por që, falë mjeteve të tija, të thjeshta në dukje, por të mprehta në veprim dhe operim, ia ka arritur që kjo farë të mbijë dhe të rritet, duke tërhequr vëmendjen, jo vetëm të kalimtarëve të thjeshtë, por edhe të studiuesve e shkrimtarëve më në zë të kombit shqiptar, që veprën e mirëpritur “Krizë si dehja nga entuziazmi modern”, ta kenë në bibliotekën e tyre, jo thjesht si kënaqësi estetike, por edhe si pastërti mendimi e shpirti, e në fund të fundit për të edukuar vetveten e për të marrë guxim prej saj.

Vepra e Kadri Ujkës i plotëson më së miri tri cilësitë e domosdoshme dhe themelore të një veprë letrare: Kënaqësinë estetike, që e tërheq lexuesin për të shfletuar e për të ndjekur rrugëtimin e tij drejt të panjohurave, që trajton vepra, Emocionin që arrin ta ndez qënien prej shfaqjes së botës së fakteve dhe trajtimit të ngjarjeve dhe argumeteve si dhe Mesazhin që përcjell vepra që i jep lexuesit një frymëmarrje për të menduar në udhën e horizonteve të pazbuluara.

E kisha vënë në një anë të tavolinës veprën e fundit të Kadri Ujkës, pasi ma kishte rekomanduar ta lexoj Luigj Pepaj dhe më befasoi se Kadri ma kishte nisur librin me autograf çka ma rriti obligimin për ta lexuar, duke dhënë edhe ndonjë mendim, megjithëse libra të tillë janë pak të veshtirë për t'i rrokur menjëherë. Disa herë, kur kthehesha nga puna, nuk e gjeja aty ku e kisha lënë. Më kujtohej dhe i lëshoja zë bashkëshortes duke e pyetur se ku e ka vënë librin e Kadri Ujkës! Ajo më thoshte se aty është, por vetëm sa pastrova pluhurin... Dhe, kjo ishte një arsye e një nxitje më shumë për ta lexuar veprën e re të mikut të fjalës së lirë, nga Malësia e Madhe, një fole e ngrohtë e shumë librave nga të gjitha gjinitë që i bëjnë një nder të madh krahinës “Nderi i Kombit”

Për ta lexuar librin e Kadri Ujkës, nuk është vetëm një detyrim krijuesi, por diçka më shumë e zbirilon kuriozitetin. Në një zonë, të pastër shpirtërisht, si alpet, por



që i mungon komoditeti akademik, siç janë institucionet e larta të kulturës dhe letrave shqipe, Kadri Ujkaj e ka zëbërthyer dhe materializuar thënien e Sokratit: “Është e vështirë të dallosh se ç’ndodh me shpirtin, por është krejt e lehtë të dallosh se ç’ndodh me shtetin!”. Poeti Ndoc Gjetja në një varg të poezisë së tij thotë: “Ah, sikur pushtetin ta kishte shpirti!”

Kadri Ujkaj ka një veçanësi në rrjedhjen e dëshmive që e ndriçojnë fytyrën e argumentit dhe të ballafaqimit me fenomenet e ditës, pa harruar ato në kohë të ndryshme. Ai nuk mbyllet si në katër muret e errëta të manastireve të murgjve dhe të bie pre’ e filozofive meditative, por ai del, lëviz, kontakton, debaton, shfleton, takohet me shkrimtarë, poetë, historianë e njerëz të profesioneve të ndryshme, jo vetëm nëpër faqet e librave të tyre, por edhe fizikisht, për të kuptuar tek ato se çfarë kanë lënë në fundin e shpirtit të tyre pa i hedhur në letër dhe, pasi e ka mbushur bllokun, ulet e shtron trasenë e vet të sintezës dhe analizës që ka marrë të shtjellojë mbështetur edhe në shkëlqimin e “mistrisë” së talentit të tij.

Libri i ri i Kadri Ujkës, këtij “qytetar nderi” i frymës kritike në letërsinë shqipe, fillon me një vështrim analitik: “Kushtrimi i nderit pagan, ndryshe klithmat e seksit si tabu”, duke iu referuar thënies së Leon Tolstoit se tragjedia më torturoese në të gjitha kohërat është, ka qenë e do të jetë tragjedia e dhomës së gjumit. Ndërkohë që bota përendimore është e tejmbushur me skandale seksi, duke rrokur edhe sferën e çmendurisë dhe krimin dhe duke prekur edhe fëmijët e të miturit, për të vazhduar me ato të vetëdijshme të politikës, autori Ujkaj shtron me të drejtë pyetjen:

“Kujt duhet t’ia dhurojmë sinqerisht ngrohtësinë e zemrës dhe të shpirtit më

parë se bashkëshortes në këtë botë!” E, ai nuk vonon të japë vetë përgjigje: “Gruja është nëna e jetës, e cila ka ardhur në këtë botë si krijesë fisnike, civile, shpëtimtare dhe për seksin tjetër, mashkullin, shëndeti total i të cilit, nga ai fizik, seksual e mendor, mund të realizohet i plotë, vetëm në kontekstin fizik, moral e funksional si partneritet burrë-grua!”

Ndërkohë që seksi femëror në botën e tejskajshme të qytetërimit dhe lirive që e dhunojnë vetë lirinë është kthyer në një fabrikë fitimi dhe kunora e shenjtë nuk po ka shkëlqimin e duhur hyjnor, kur divorci është bërë si buka me djathë, autori Ujkaj thekson se duhet të mbjellim dashuri që të mos korrim urrejtje.

“...në kontekstin shqiptaro-balkanik patriarkal, sa klasik, sa postmodern, ku gruaja shikohet si pronë e mashkullit me veto mbi jetën e saj, kuptohet statusi i këtij të fundit prej kapidani tragjikomik. Kështu, ky i thotë vetes: “Pse t’i them gruas, më fal, falemindërit apo të dua?!”...prezenca e burrit në lindje e lehtëson ndjeshëm dhimbjen e bashkëshortes...!” Ky shkrim i sintetizuar është një analizë e mirëfilltë psikologjike në fushën e ndjenjave dhe raporteve femër-mashkull në qelizën e familjes së një shoqërie si e jona, ku institucini i faljes ende i ka themelet e brishta.

Falje ka kërkuar Papa i Romës... Falje ka kërkuar publikisht presidenti i SHBA-ës, Bill Clinton, po falje kurrë nuk ka kërkuar një pushtetar shqiptar, apo qoftë edhe një bashkëshort i zhënë në faj, por me të gjithë mënyrat është kacavarur si gjarpri pas justifikimit. Të mos kërkosh falje tregon se në shpirt ke një gur të zi, që e pengon çeljen e lules së dashurisë njerëzore edhe në fushën sentimentale. Asnjë në botë nuk ka lindur më fuqinë e dhunës mbi gratë. As kanuni i maleve nuk ia njeht forcën burrit mbi gruan. Njerëzit kurdoherë e kanë dashuruar të bukurën. Burrat kanë qenë aq të hollë ta zgjidhnin të dashurën edhe kur asaj mund t’i shiheshin vetëm sytë e prej tyre zbuloheshin pasqyra e shpirtit. E, sot, femra, gati nudo, me këthizë e gjokse jashtë, kjo në art, në skenë, në këngë, e kërkon dashurinë, respektin dhe famën nëpërmjet zhveshjes. Në analizën e tij Ujkaj e analizon xhelozinë si një shtrigë e dashurisë, si një vrastare e një çifti familjar, duke iu referuar thënies së Shekspirit, i cili e quan xhelozinë mostra me sy jeshillë, që kërkon ta hajë përsëgjalli krijesën e vet. Shpërdorimi i parakohshëm i vetvetes e dobëson harmoninë dhe lumturinë, duke krijuar shpejt një tkurrje shpirtërore dhe një gjendje tensioni në marrëdhëniet intime. Bota po shkon drejt martesave të një seksi apo martesave me robotë. Sidoqoftë Ujkaj, në këtë analizë nuk është vetëm rrëfyes dhe paralajmërues, por ai arrin të vërë përballë fenomenet e kohës duke e bindur lexuesin, për rrugën që duhet të ndjekë në drejtimin jetësor.

Libri i Ujkës e ka marrë titullin si një zëbërthim filozofik i thënies së Karl Poper (1902-1994): “Nuk ka dyshim se adhurimi i fuqisë politike është një prej idhujtarive më të shëmtuara njerëzore, është kuptimi i kohës së kafazit dhe i nënshtrimit të njeriut!”

Kadri Ujkaj, me këtë botim dinjitoz, i shkrin xeheroret e jetës në kupën e artë të fjalës plot mesazhe dhe gurra e shpirtit të tij krijues ka prurje gjithnjë të freskëta, të cilat e çlirojnë aspiratën nga kurthi. Sot për sot botimet, më së shumti, kur ato promovohen kanë lavdinë, për mbulojë dhe pak hipokrizi për shtrojë. Nuk e di pse koha e re, koha e shpërthimit dhe e papërmbajtjes, koha e etjes për liri, që nuk do t’ia di paslirisë e shkalaziti kritikën dhe vetë kritikët i struku në fund të skutave të mohimit! Megjithatë, ajo nuk mund ta humbë kritikën, se një nga rojet e forta dhe plot vitalitet të saj është edhe krijuesi dhe shkrimtari nga Malësia e Madhe, kritiku letrar Kadri Ujkaj.

Autori i librit në fjalë pohon se disidenca nuk është si kollarja që dikush mund ta varë në qafë...por ajo është një sjellje estetiko-filozofike e krijuesit, ndryshe sfida e fjalës si gjetje estetiko-filozofike. Ujkaj vë në tëh të penës së tij lojën e recensuesve, të cilët për t’i dhënë një forcë trajtimit të temës së veprës së një autori, e paraqesin atë si disident, fjalë aq e preferuar në kohën tonë, një pelerinë që të mbron nga shiu i kritikës...

“Heshtja mjerane ndaj fatit tragjikomik, jo vetëm të monumentit të Migjenit, të kthyer në një mjedis urinimi deri në vitin 2010, degdisja në fshatin Kukël të Mjedës, ironia monumentale me monumentin anonim të Fishtës, rrethimi me ndërtime i Teatrit “Migjeni” dëshmojnë cinizmin më të madh ndaj vlerave kulturore të Shkodrës!”. Kadri Ujkaj e “merr për dore” Migjenin, duke ecur në piacën e qytetit verior, me kulturë të lashtë sa themelet e kalasë “Rozafat” e me za sa zani i këmbanës së parë, për të shpallur se koha e mjerimit nuk duhet të përsëritet dhe se koha e administrimit të shpirtit të revoltës në shprehje të vërtetës ka kohën dhe vendin e vet si kryefjalë e ditës.

Harresa i merr në gjirin e saj politikanë, princër, mbretër, kryetar shtetesh! Por sa do të fortë ta ketë pushtetin, ajo nuk mund ta fitojë duelin me shkrimtarin, me poetin, me artistin, sepse këta janë shpirti i një kombi, nga ku gatuhen dhuratat e çmuara të fjalës dhe gjuhës së një nationi. Ujkaj pohon se vetëdijen kombëtare na e ngjizën krijuesit e mëdhenj të Rilindjes sonë dhe shtron pyetjen: Pse lejohet në mënyrë institucionale të injorohet statusi i krijuesit, apo kryqëzimi i elitës së shoqërisë civile, shkrimtarët dhe artistët, si oponencë profesionale?! “Heshtja përballë këtij realiteti absurd në llojin e vet vjen vetëm si mashtrim ndaj ardhmërisë sonë, civile dhe evropiane, si komb!”.

Dua të them se Kadri Ujkaj ka një dialog me Agollin, me Kadarenë e si të thuash ai i zbërthen komcat e këmbës gri të realitetit shqiptar. E Ismail Kadare do të shprehej për veprën e Kadri Ujkës: “Unë i vlerësoj librat tuaj nga pikëpamja profesionale, me përjashtim të ndonjë komplimenti ku duhet patur kujdes. Më ka befasuar analiza që ju i bëni romanit tim “Qyeti pa reklama!”

Kadri Ujkaj është pena e “Qytetit pa reklama”. Le të trokasim në portën e tij gjithsecili në mënyrën e vet.

Pergatite nga Zef Pergega, studiues dhe publicist, Detroit, më 13 shkurt 2015

# Thesaret dukagjinase e pathëna që i ka munguar një krahine

VOC DEDA, PATRIOT DHE ARTIST I FJALËS SË SHKRUAR, CILËSOHET TË JETË INDIVIDUALITET I SPIKATUR NË HITERLANDIN DUKAGJINAS QË SHTRIHET NË TRE SHTETE TË EVROPËS JUGLINDORE

1.

Ka njerëz në këtë botë që gjejnë kohë të martirizohen në një farë mënyre, në përpjekje për të dizenuar mirë e bukur fytyrën e krahinës prej kah kanë origjinën. Duke u ndjerë me vetëdije histerar i krahinës së Dukagjinit, Voc Deda është njëri nga këta njerëz që e kanë për krenari mundimin prej Sizifi, për të sakrifikuar nga koha e prehjes e argëtimit, e me ndihmën e trapit të dijeve të kapërcejnë vaun. Të dalësh matanë bregut do të thotë të shprehesh për vendin e të parëve të tu, vendlindjen tënde, e cila është mistike e sublime njëherësh.

Thjesht për pak njerëz, kujtojmë se Voc Deda ka lindur dhe ka marrë mësimet e para në fshatin Khan, që është njëra nga gjymtyrët më vitale të krahinës së Pultit e të Dukagjinit në përgjithësi. Voci lëshoi shtat në një çerdhe me tradita patriotizmi e atdhetarie. Të parët e tij ishin punëshumë e fjalëpakët. Edhe pse kishin për çka, pjesëtarët e nderuar të fisit nuk rrahën gjoksin edhe kur e thelluan hullinë e virtyteve dukagjinase. Biri i Xhanit në fillim u pais me një arsenal dijesh të sakta e të qëndrueshme. Kishte në xhepin e setrës dy diploma. Kishte përfunduar dy fakultete në shkolla të larta civile e ushtarake. Mandej do të vinte një kohë e gjatë kontributesh të lexueshme. Harku i kësaj kohe përmbledh tri dekada e gjysëm. Nuk janë pak 35 vjet punë vetmohuese si administrator i niveleve më të larta në subjektet prodhuese të kohës dhe si ushtarak i denjë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Voc Deda në parim shërbeu në ato pozicione pune ku shpalosja e dijeve vetjake të tij, do të rrezatonte në një komunitet sa më të madh në numër rezidentësh. Në strukturat më të larta të pushtetit vendor dhe në ato qeverisëse në zonën e Dukagjinit dhe jo vetëm, do të shënjonte gjurmë të dukshme, Voc Deda. Si një kuadër i përgatitur si jo më mirë, shërbeu në Khan e Theth, si kryetar kooperative, anëtar i Komitetit Ekzekutiv i Rajonit të Dukagjinit dhe në Grizhë të Malësisë së Madhe si komisar i Shkollës Stërvitore Ushtarake për forcat në rezervë të Ushtrisë

Popullore. Voc Dedës nuk iu përgjarg puna nëpër duar. Mori lëndat e stimuj moralë. Punën e frutshme mund ta vazhdonte në se nuk ndodhte ajo çka ndodhi në fundin e viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, kur ndryshoi sistemi i drejtimnit shtetëror dhe në Shqipëri. Rrëzimi i Murit të Berlinit kishte ndodhur ndërkohë.

2.


Fundi i karrierës si nëpunës i shtetit të vet, e zuri Voc Dedën në karrigen e Shefit të Kuadrit në Regjimentin Kundraajror të Tepes në qytetin e Shkodrës. Atij nuk i erdhi mirë të ndërpriste në atë bashkohë shërbimin e frutshëm ndaj shtetit e popullit të vet. Madje ai ndenji disa netë me gjumë të shkalafitur për t'i gjetur një ortak pensionit të parakohshëm. Dhe më në fund e gjeti: do t'i kushtojë zëj me të hershme që nje bota, asaj të përcjelljes së kumteve. E këtë profesion të ri do ta realizonte nëpërmjet shkrimtarisë. Zgjedhi këtë zana pas pati krijuar përvojë në vitet e mëparshëm. Kishte bashkëpunim të rregullt me organet e letrave të kohës së vet. Ndërkohë kishte studjuar, hulumtuar e lexuar vazhdimisht dhe kur u bind se hambari i dijeve ishte dingapërmajë, nisi të shkruante libra. Librat që shkroi Voc Deda ishin të karakterit të dokumentimit e arkivimit të vlerave më të mira shpirtërore, të përfuara në hiterlandin dukagjinase e në mbarë viset ku shtrihet dhe i shqiponjave.

Voc Deda është autor i 13 librave. Nuk njihet ndonjë krijues tjetër në Rrafshin e Dukagjinit të ketë dhënë më tepër kontribute në fushën e letrave. Një rekord jo vetëm kombëtar, por edhe në nivel rajonal, sak në rrafshin ballkanik. Edhe pse është një mision i vështirë zbrëthimi dhe përcjellja e vlerave të shkrimtarisë së Voc Dedës, ne e kemi marrë përsipër ta çmontojmë "makinën" e librave të shkruar prej tij e të zbrëthojmë detaje të krijimtarisë së tij, të frutshme e të larmishme.

3.

"Thesare dukagjinase" është saga krijuese më e plotë dhe më e rëndësishme e rremit krijues të Voc Dedës. Libri përmbledh

6 volume. Duhet të kesh angazhim titani për të zbritur në tunelin e shkrimeve me këtë tematikë, ku dhe historianë e studjues shpesh nuk guxojnë të futen në terrinë për ta parë me sytë e Argusit dritën që rrezaton



falë një talenti të spikatshëm e një durimi ilir të Voc Dedës. Po çfarë përshkruhet me imtësi e saktësi në faqet e librit të parë të thesareve dukagjinase? Në krye të herës, aty shpalosen vlerat e njëmendëta morale e shpirtërore të një rrafshi gati kontinental ku shtrihet e mrizon Dukagjini. Nëpër substraktin e librit gjejnë strehë e ndjehen mirë urtanët, dëshmorët, aedët, martirët, legjionet e fjalëve të urta e gjëgjëzave dhe mendimi konstruktiv i udhëheqësve të rrafshit në kohë të ndryshme. Vlerat morale dhe shpirtërore të komunitetit që është i ngjizur heretfort dhe që nuk njeht mort, ishin dhe janë në formë mozaikësh që krijojnë gjerdanë rrezatues. Janë xhevahire mitet, legjendat, këngët e zakonet e mira të dukagjinaseve, për sa kohë nuk e durojnë përsipër pluhurin, hijen dhe mjergullën.

Në të shumtën e rasteve qerpikët e ndritshëm të qëndresës dukagjinase e kanë të nevojshme krehjen e butë. E këtë punë që është jo pak e mundimshme, Voc Deda e kryen me pasion e durim. Sepse siç e kemi theksuar dikund në rreshtat e këtij shkrimi, është artist i mendimit dhe i fjalës së shkruar. Mozaikëve të shndritshëm, Voci ua hoqi me delikatesë pluhurin e rënë përsipër tyre, dhe i sjell

tek lexuesi me dritëhijet dhe shkëlqimin e dikurshëm apo të mëparshëm. Lexuesi është kureshtar e me të drejtë shtron pengun (pyetjen): si e sa mirë e njeht realitetin e trevës me kufij të paanë të Dukagjinit, ky autor anipse është bir dukagjini? Përgjigja të vjen menjëherë në majë të buzëve. E çoi dëshira e pasioni, por dhe detyra që mori përsipër si intelektual i kalibrit të epërm, kullë më kullë, log më log, shpellë më shpellë. Autori i librit "Thesare dukagjinase" e ka të trashiguar dijen për historinë dhe ritet krahinore të rrafshit të malësisë që thërritet Dukagjin, por nuk është mjaftuar me këtë dije. E ka zgjeruar "vathën" e tyre. E ka pastruar me vullnet baltën e hedhur nga kokoroçë që i pati si çibanë e jopak në numër Shqipëria, e Dukagjini si pjesë e saj. Është kjo arsyeja e daljes në dritë me të gjithë shkëlqimin e vet të këtij thesi të madh me thesare vërtet të ngjashëm me brilantët.

4.

Tjetërgjë e shqetëson dhe e nguc të rrëfej autorin e "Thesare dukagjinase" në vëllimin e dytë. Gjenezja e vëndit të origjinës së autorit është në fokus të shpalimit të këtij libri me volum të kënaqshëm. Pulti, është thënë e stërrthënë teepakta nga dhjetra historianë, eksplorues e hulumtues, e ka të shkruar në ballinë eposin e ngjizjen e njëmendët të një komuniteti që sheh larg dhe e përbuz si pakkush mbi shpinë të dheut mekanizmin e përljes së mesit të trupit që mbështetet mbi dy këmbë sak më të forta se të Anteut. Në Pult e rrethinë, pasi të ka marrë përdore autori, të duket sikur të bind se bash aty e ka strofullën e vet "tigrin" i qëndresës e vitalitetit dukagjinase. Vitaliteti në këtë rast merr kuptimin e jetëgjatësisë in mortels siç thoshte dikur e në një kohë latine që kishte ndërtuar perandorinë e Perëndimit me kufij e sinore të mezirrokshëm. Lexuesi i vëllimit të dytë të "Thesare dukagjinase", pas leximit e ka më të kthjellët trinën e vegimit dhe plorin e kujtesës. Nuk është pavënd të shprehemi se këtë lloj hulumtimi nuk e kemi ndeshur në hulumtues të tjerë si Zef Mark Zeka, Lazër Stani, Luigj Shyti, Zef Gjeta, Prelë Grimaj,

Zef Mala, Prelë Milani, Mhill Pali e një numër studiuesish të tjerë të gjenezës, rritjes e zhvillimit ndër mote të hiterlandit me kufij të mahnitshëm. Në Pult, sipas Voc Dedës, janë me qindra ngulmimet e banorëve të hershëm të krahinës. Ata ngjajnë me pemë që i kanë rremat në një kurorë kozmike. Autori i "Thesare dukagjinase" nuk bën kinse i vjel kokrrat e pjekura nëpër degë, por i vjel vërtet kokërr për kokërr. Ndërkohë ai përgatit dhe shportën ku do t'i vendosë me kujdes pa jua hequr përsipër atë cipën e himenit që e kanë të shenjtë vajzat edhe në Dukagjin.

Vendngujimet kanë emra e toprakë. Doke e zakone. Të admirueshme dikur e lehtësisht të modifikueshme për të qenë të dobishme për sot e për nesër. Familjet nuk vegjetojnë por ngarendin në epoka të largëta e të afërme duke u njëtrajtësuar me shpirtëra që nuk i bëjnë zap varrezat e rëndomta, të cilat i shohim edhe nëpër Pult e rrethinë, në majë a në shpatinë kodrinash me brinjë ku rrëshkasin me nge, rrëqe që ligjërojnë me zërin e melodishëm të Lasgushit e Kutelit. Dinamika e botës mashkullore në provincë, zë vendin që meriton. Ka saktësi e kurrfarë glorifikimi në paraqitjen e jetës e punëve të mira të individëve që peshojnë rëndë në atë rrafsh, ku dhe moti nuk harron të jetë i kthjellët, në të shumtën e ditëve me diell e me dritë të cilitdo viti kalendarik të përshkuar andejpari. Toprakët e themelet e kullave marrin trajtat e frymorëve e flasin pa asfarë droje me autorin e tekstit të kalibruar me dinjitetin që meriton. Rrëfejnë bukur e pa bërë lak as dredha, zakonet bukurane që të parët i lanë të varura në vargojtë e qemeret e çdo oxhaku në Pult, Dukagjin e në pjerrinë më të largët. Doket e zakonet, Deda i luçidon për tu dukur më açik nga bashkëkohësit e vet. Të njëjtin fat kanë dhe mitet e legjendat. Këto në këto troje e në këtë hapësirë të pafundme besohen më tepër se tjetërkund. Janë në të drejtën e atit tek i cili besojnë, ta kenë të palëkundshëm këtë besim si hulli arsyetimi.

(vijon në numrin e ardhshëm)  
Dashamir CACAJ

# MANIFESTIMI TRADICIONAL "ZËRI I VËLLAZËRISË-2015", NË 15 VJETORIN E THEMELIMIT TË SHOQATES "MARTIN DRESHAJ"...

## Reportazh...

Në kuadër të 15 vjetorit të themelimit të shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me 12-13 prill 2015, u zhvillua manifestimi tradicional "Zari i Vëllazërisë-2015". Nuk kishte si të mungonte me pjesëmarrjen, por edhe me prezantimin e saj mjaft të mire, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", ajo që për shumë vite me rrallë i jep to-

kagjinin, Shkodrën në këtë manifestim të përvitshëm. Udhëtimi do të fillonte në mëngjesin e së dielës herët. Autobusi komod, me dekor mjaft bukur dhe i drejtuar me kujdes nga shoferi me përvojë, Halimi Halili, do ta linte Shkodrën rreth orës 07.00 të mëngjesit...

Një rrugëtim i qetë, me plot atmosferë, muzike dhe humor. Një ditë e bukur me pak re dhe një pritje vëllazërore do të na rezervohet në Pejë, nga organizatorët.

nimente të tilla, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", i dorëzoi pjesëtareve të familjes Tahiraj një titull nderi "**Mirënjohja Mehmet Shpendi**" PR kontributin në luftë për liri, me motivacion: "**Familje që ndër breza mbrojti tërësinë tokësore shqiptare, pa kursyer as jetën. Shembull i jashtëzakonshëm heroizmi, flamur i papërkulur në beteja, zjarr i pashuar në zemrat e të gjithë shqiptarëve, burim i pashuar frymëzimi, pushkë e mbushur gjithmonë në shërbim të atdheut**". Me

përvjetor do të sillte emocionet, dhe vështirësitë e punës të bërë në vite, me mjaft sakrificë, por me shumë dashuri e përkushtim.

E përjetuam këtë dokumentar me emocion, por edhe me respekt e krenari për punën e bërë nder vite...me një pjesëmarrje të kënaqshme. Mendojmë se ishte mjaftueshëm për të shpreh falënderimet e tona, për gjithçka që kana bere këto shoqata me bashkëpunimin e tyre të suksesshëm në 15 vite.

Mbrëmja ishte e miremenduar për të qenë relaksuese, argëtuese por edhe produktive, në ambientet e mrekullueshme të Restorant "Shpella e Bobit". Te gjitha grupet pjesëmarrëse do të shkriheshin në një trupë të vetme... Aty ishin nga Klina, Idrizi, Teuta, Ismeti e Zeqiri. Nga Rrozhaja poeti Aliu, Antoni nga Tuzi dhe Tahiri, miqtë nga Metvegja, Xhemali nga Gjilani e Bardha nga Gjakova, në këtë ambient shumë vëllazërore. Pjesëtarët e grupit tone ishin mjaft miqësor, aktiv dhe të respektuar.

Këngë, valle, shkëmbime bisedash dhe përvojash, trokitje gotash dhe shkrepje të aparatit do të fiksonin në kujtesën e secilit, një mbrëmje e paharruar.

Ansambli autokton "Rugova", grupi i valleve të koreografit Aldo Nika nga Shkodra, grupi muzikor "Shpëtimi" nga Metvegja, këngëtarët Prek Mrishaj e Bardhe Tusha, disa këngëtare të rinj nga Peja, te rinjtë e shoqatës sonë, Daniel Kopsaj e Kole Qaferanaj, i dhanë ngjyre, ritëm dhe atmosferë kësaj mbrëmjeje që zgjati deri vona.

Nuk kishte ndonjë rast më të mirë se kjo atmosferë vëllazërore dhe festive, që drejtuesit e dy shoqatave të ndanin stimuj dhe certifikata mirënjohje për punën e bërë nder vite. Me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës "Martin Dreshaj", në emër të kryesisë së Shoqatës sonë, Kryetari Ndue Sanaj, i dorëzoi kryetarit të kësaj shoqate titullin "**Mirënjohja Martin Camaj**", me motivacion: "**Për kontribut të shkëlqyer në grumbullimin**



Varresat e dëshmorëve, Novesela

nin këtij spektakli kulturor.

Mjaft të ngarkuar me angazhimet e punës, por edhe me përgatitjet PR vendosjen e shtatoreve të luftëtarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj, një pjesë e anëtarëve të kryesisë e kishin të pamundur pjesëmarrjen...

Falë këmbënguljes të kryetarit, por edhe mbështetjes të mundësorëve, një grup prej 25 vete, drejtues dhe aktivist të shoqatës, valltarë, këngëtarë dhe artistë, përfaqësuan denjësisht Du-

Pas një ceremonie të zhvilluar në qendër të qytetit, ne patëm koha dhe rast të ndjenim zhurmën dhe mikpritjen e këtij qyteti plot jeta... Pasdite programi vijoi me një veprimtari përkujtimore në varrezat dëshmorëve të fshatit.. Novosele. Aty do të bëhej një ceremoni në përkujtim të 16 vjetorit të rënies të dëshmorit Shaqir Tahiraj, vëllai i njërit prej veprimtareve të shoqatës "Martin Dreshaj", Ali Tahiraj.

Si gjithmonë e kujdesshme në eve-

ketë rast, mjaft emocionuese ishte fjalla përshëndetëse e bashkëluftëtarit të dëshmorit dhe veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Naim Prelvukaj, por edhe homazhet në nder të të rënëve dhe fotot me familjarë të dëshmorëve dhe të pranishëm.

U larguam nga Novosela, duke marrë më vete emocionet e çastit, respektin për dëshmorët e lirisë, por edhe një kafe miqësore të ofruar nga familjarët e dëshmorit në një ambient mjaft relaksues që ne tashmë e kemi frekuentuar disa here. Ajo që na ka bërë çdo vit përshtypje ka qenë serioziteti dhe vëmendja që strukturat e pushtetit vendor tregojnë ndaj veprimtarëve të tilla, qoftë me pjesëmarrjen e tyre, por edhe në shoqërimin me forca sigurie dhe kushte të tjera lehtësuese, gjë që tek ne lë për të dëshiruar.

Rreth orës 17.00 u kthyem përsëri në qendër të qytetit të Pejës, u kthyem përsëri aty ku 15 vite më parë e filloj veprimtarinë e saj kjo shoqate, me një program kulturor dhe nacional, në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve nga asimilimi dhe diskriminimi Serbo-Malazez.

Një grup i Shoqatës kishte përgatitur një Dokumentar, që në këtë

Grupi i valleve të Shoqates "Atdhetare-Dukagjini", me koreograf Aldo Niken



Foto pranë monumentit të Adem Jasharit



Homozhe ne Monumentin e Heroit Shkelzen Haradinaj



Varrezat e dëshmoreve ne Prekaz

dhe promovimin e vlerave kulturore, artistike e identitare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, brenda shteteve fqinje; për bashkëpunim të frytshëm me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" në përmbushjen e misioneve dypalëshe".

Të gjitha ishin të mirëpritura dhe të rëndësishme, por e shohim të rastit të citoj dy prej tyre: Se pari, Mjeshtri i pun-

imit artistik te veshjeve tradicionale, Zef Lulash Sokoli në bashkëpunim me shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", i dhuroj kryetarit të shoqatës të Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", Ukshin Jashari një jelek tradicional të veshjes së zonës tonë. Se dyti, e paraqitur në formën e surprizës, por e përgatitur me një mjeshtri të veçantë artistike, ishte

Grupi perfaqesues i Shoqates me bacen Rifat Jashari



itueshme moderne për turiste, historiane e studiues nga gjithë bota..

Në hyrje te varrezave te dëshmorëve të fshatit Prekaz dhe te rënëve të familjes Jashari, na priti një djalë i familjes, Murat Jashari. Tek bëmë homazhe dhe na foli për ditën e zezë për familjen e tij, ndiem dhimbje e krenari, por edhe e kuptuam se sa i rëndë dhe i madh është çmimi i lirisë për këtë familje e për gjitha Kosovën.

Sa më shume i afrohem kullës legjendare, aq më i madh ishte emocioni! Pamë atë ndërtesë të bombarduar e të bërë shoshe nga gjylet e topave, që përsëri qëndronte në këmbë, si për të treguar brezave dhe gjithë botes historinë dhe dëshmitë e saj. Në dhomën e pritjeve, që ishte e rezervuar vetëm për delegacione, na priti baca Rifat Jashari...

Fjalët janë të pamjaftueshme, por emocioni dhe kujtimi për secilin nga ne, do të jetoj gjate i fiksuar në mendjen dhe në foto. Në emër te Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", fjalën e mori kryetari, Ndue Sanaj, i cili pas shprehjes së dhimbjes dhe krenarisë për këtë familje te madhe, legjende te nacionalitetit shqiptare, ju drejtua bacës Rifat: Baca Rifat, në emër të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" ju dorëzoje titullin "Mirënjohja Mehmet Shependi", familjes Adem Jashari, me këtë motivacion: "Legjendarëve të historisë së Kosovës, feniksëve të pavdekshëm, që njomën tokën e Kosovës me gjakun e tyre, për të mbetur përherë altarë të heroizmit dhe atdhedashurisë". Gjithashtu, ju dhurojmë juve, një gubere, të punuar nga mjeshtri Zef Lulash Sokoli, i cili u ngrit ja hapi dhe ja dorëzoje, i hoqi xhakëtën dhe ja veshi, dhe me te veshur bëmë disa foto. Ai, shprehu kënaqësinë, por dhe na nderoi me medaljonin e UÇK-se, familja Jasharaj.

Pas atyre çasteve të paharruara në Prekazin e lavdishëm, në kullën legjendare të Jasharajve u ndalem në qendër te qytetit Skenderaj, pranë monumentit te Heroit Adem Jashari! Bëmë homazhe pranë monumentit madhështor të Adem Jasharit dhe pastaj u nisem për në Shkodrën tone.

Me pak rreshta dhe me shume foto u përpoqëm të sjellim për ju lexues të gazetës "Dukagjini", një reportazh nga ky udhëtim i yni, i radhës në Kosove.

Pergatitur nga Lulash Brigja

## SI PËRHERË PRANË KOMUNITETIT

Formula kryesore sot në politikë është të jesh pranë njerëzve, pasi kështu je sa më afër realitetit dhe fitores. Sa më larg tyre aq më i pa besueshëm je. Sa më afër njerëzve të gjendet një politikan, një deputet apo i zgjedhur vendor aq më mirë di të ndërtojë punën në shërbim të këtij populli, që po jeton në ditë të renda të krizës ekonomike. Një nder këta njerëz, një nga të këta zgjedhur, i kudo ndodhur mes komunitetit të tij, duke ndarë me ta vështirësitë, duke qarë hallet ku po të dhemb e ku po të djeg është Besnik Xhemali (Brahimi). Kryetari shembullor i Komunës Bërdicë.

Ky kryetarë i përfaqësues i subjekti të PS, fitoi në mënyrë spektakolare në një bastion tradicionalisht të djathtë. U soll në mënyrën më dinjitoze me kundërshtarit, larg fyerjeve, intrigave mllefeve inatçare dhe shigjetave idhnake dhe gjuhës helmatisur të urrejtjes. Ai kudo që trokiti kishte busull orientuese vlerat e një djali, një burri, një prindi në bashkëfshatari me virtyte më të mira si bujaria, fisnikëria, zemërbardhësia, sinqeritet, gazi, hareja, guximi dhe përkushtimi për te marrë përsipër përgjegjësi te përballuar sfida të mëdha. Kudo që hyri, nder fshatra, lagje shtëpi e familje gjeti vlerat më shenjta njerëzore të një komuniteti vital të lodhur nga politika dhe të përdhunuar na pushtetarët gërbujë veç për interesin e barkut dhe xhepave të tyre. Besnik Xhemali sot është idhulli i këtij komuniteti si amanetqare i mirë, menaxher i talentuar, si njeri që nuk del nga fjalët, që në plan të parë ka interesat e komunitetit e jo siglat politike. Besë Xhemali, që flet edhe ngre zërin dhe atëherë, kur liderit politik, ministrave apo kryeministrit nuk i pëlqen, por Besnik Xhemali flet pak dhe saktë, flet drejt e pa hile dhe fjala i zë vend qoftë në popull, qoftë në strukturat e larta shtetërore. Besë Xhemali me integritetin e tij si birë i kësaj krahine, si djalë i fisëm i një familje shembullore me një edukate prindërore të shëndetshme. Ai dhe vetëm ai beri të mundur fitoren e PS dy herë rad-



hazi në Komunën e Bërdicës në vitet 2011 e 2013. Nuk ishte e lehtë të fitoje dy herë në një bastion tradicional të djathtë ku fitoret e se djathtës kishin qenë plebishitare. Kjo fitore erdhi si rezultat i asaj formule politike pranë njerke, për njerëzit dhe me njerëzit në mbajtjen e premtimeve si dhe zgjidhjen e halleve dhe problemeve jetike të tyre. Pas fitores Besë Xhemali nuk ishte më Kryetari i Komunës i Parisë Socialiste, por kryetari, shoku dhe avokati i hedheve te mëdha të gjithë komunës së Bërdicës. Besë Xhemali kurrë nuk pranoi t'i diferencoj njerëzit të majtë e te djathtë, të nënës e të njerëzës, të kuq e të zi, dele apo dhi siç ngjet rëndomtë nga fanatikët ekstremist të gjitha forcave politike. Besë Xhemali nuk di të flas fjalë pompoze, me lule e lajle mashtruese, kur flet e mban fjalën. E kujt nuk ja mbajti fjalën, cilit do që i premtoi Ai jeton me hallet dhe problemet e këtij komuniteti, me zemër bujare dhe vështroi të mëdha ekonomike. Ai nuk njeh lodhje, nuk njeh orar pune në shërbim të këtij populli që e do aq shumë, të cilit i ka fituar zemrën me modelin e ri si shëmbëllim e vet, si veprave te dobishme për ta. Besa gjendet për herë pranë njerëzve, zemra e tij është e hapur, dera e tij është çelur për këdo pa orare zyrtare. Sa herë i ka shkuar dita në fshat pranë njerëzve. Sa herë se bashku me shokët e tjerë dhe të inspektorin e policisë së zonës Tahir Lekëndreu ka mbyllur shumë konflikte, pse jo edhe tepër të renda, duke parandaluar edhe vrasje dhe shtrire dorën e pajtimit edhe atje ku dukej e pa mundur. Parimi i Besës është nuk ka politikë pa popull, politika duhet të vihet në shërbim të interesave të popullit, jo sot të kërkohet votën e nesër të përmbysë trevesen. Besë Xhemali është kundër kësaj politike të ligë, ndaj gjendet pranë të gjithëve, pensionistit, të sëmurëve, të varfërve ma përkrahje dhe përpiqet që tua lehtësojë dhimbjet e tyre. Ai gjendet pranë pran nxënësve dhe lufton të rriten plot edukatë njerëzore dhe atdhëtarie. Besë Xhemali kur erdhi në krye të këtij komuniteti nuk premtoi mrekulli, por gjatë këtyre katër viteve ka bërë jo pak ndonjëse realisht nuk ka pasur as një ndihmë nga politika e madhe dhe shteti. Ai synonte dhe shpresonte të bënte shumë më tepër dhe për këtë ndjen dhimbje dhe e ka treguar me gisht shkakun. Besë Xhemali është një rast unikal që guxon dhe komunikon direkt me publikun duke i apeluar qeverisë dhe Kryeministrit: - Mos harroni Bërdicën, mos harroni Shkodrën që ju kanë votuar për një ndryshim të madh. Unë jam përherë mes njerëzve dhe nuk mund të bëhem shurdh e të mos dëgjoj zërin e tyre. Nuk mund të behem qorr e te mos shoh vuajtjet e tyre dhe nuk mund të bëhem bukëshkalë dhe të shkelë mbi votën e tyre. Besë Xhemali shkon tek komuniteti i tij ballëhapur pasi për çfarë ka premtuar e ka mbajtur. Ka bërë shumë më pak nga sa i dëshironte zemra e tij, por ka bërë më të mirën e mundshme duke krijuar modelon shembullor të menaxherit, fjalë ëmbël, duar pastër dhe zemër bardhë. Besë Xhemali i duhet përsëri këtij komunitetit pasi tek ai shef zëdhënës in e tij. Besë Xhemali është një antibiotik i dobishëm për politikën e sëmurë nga mëkati.

RROK LAZRI, BERDICË

## U SHUA NË MOSHËN 100 VJEÇARE LEKË VOJVODA, PEDAGOGU I AKADEMISË SË FIRENCËS

Në fund të muajt shkurt të këtij viti, u nda nga jeta në moshën 100 vjeçare Lekë Vojvoda, një ushtarak shumë i talentuar, i formuar në perëndim dhe më i vjetri i Dukagjinit.

E kam si peng personal që së paku në gazetë nuk kam shkruar më parë për të. E kishim këtu në mesin tonë si një arshivë të vyer të mbyllur me një koloz (dry) të ndryshkur me shumë arki fakte historike brenda. Së paku unë kam tentuar ta hapi ndonjëherë, por jo aq sa duhej. Pavarësisht se ato fakte dhe kujtime që i kam vjeluar i kam botuar e kam si lëndë të pasur për botimet e mija historike. Më vjen keq që Lekë Vojvoda nuk ka qenë mik special i gazetës "Dukagjini" as një herë në të gjallë të tij. Gazeta e hapur ka qenë, por Lekë Vojvoda nuk u ftua të flasë për të. Nuk ka pasur as një dashakeqësi, por thjeshtë një mungesë vëmendje që na karakterizon si popull për të gjallët, qoftë edhe për ata nga më shquarit. Intelektuali në Shqipëri është shumë i vetmuar dhe i mos përfillur nga turmat. I tillë ka qenë edhe Lekë Vojvoda për më se 75 vite në 3-4 regjime që jetoi. Edhe ditën që u varros të gjithë thanë një të vërtetë të pa kontestueshme: Vdiq një burrë i mirë,

por harruan apo nuk e dinin ta vlerësonin se -Lekë Vojvoda ishte një intelektual perëndimor i plagosur rëndë nga politika. Së bashku me ketë postmortum në përkujtim të Lekë Vojvodës nuk mund të ndahet ai babai, gjyshi dhe stërgjyshi i tij që ishin:

### NJË SHEJZË HISTORIKE E DUKAGJINIT

Lekë Prelë Alia për ata që njohin mirë historinë, ka një autoritet i shkallës së lartë në fisin e Shoshit. "Vojvoda i parë ishte kryetari i një vllaznie të madhe dhe si i tillë përfaqësonte një këmbë fisi"<sup>1</sup>.

Funksioni i Vojvodës së parë është fituar dhe trashëguar stafetë nga Ali Marku- Prelë Alia - Lekë Prela - Vuksan Leka- Lekë Vuksani (Vojvoda).

Kjo shejzë (dinasti) e mirënjohur brez pas brezit nuk ka marrë asnjë lloj shpërblimi (rrogë siç merrnin të gjithë bajraktarët), ka vepruar siç e ka dashur e mira e vendit, pa u përzier në dallavere dhe intriga pacifiste me as një të huaj. Ka jetuar me punë të ndershme duke u qenë Kryefjalë e shtëpive të kamura të krahi-

<sup>1</sup> Fjalori i Gjuhës Shqipe, botim i viti 1984 fq. 2179. Rr.Zozi. Konf. St.Etnografike Shqiptare, 1977, fq.174.

## LIGJI I SPOSTIMIT DHE SHPËRTHIMI



AHMET DURSUN

Ligji i vetëm që funksionon në drejtësinë e pluralizmit shqiptar, është ai i pashkruar: ligji i spostimit.

Çdo vendim i kësaj drejtësie, domosdo bazohet mbi këtë ligj dhe përfundimi është:

Përdhunuesi shpallet i pafajshëm, pasi viktima ish spostuar në një pozicion të gabuar.

Trungjet spostohen dhe bëhen mobilie; sharra shpallet heroinë.

Gërryhen shtretërit, lumenjtë spostohen dhe firma ndërtimi ngrenë pallate.

Spostues, - u thërrasin këtu, veçse kur kapen matanë quhen trafikantë droge.

Vrasjet për ta janë thjesht spostim nga kjo jetë e mërzitshme, në parajsën e pa fundme. Grabitja trajtohet si spostimi i pasurisë tënde në duart e të tjerëve.

Vota mjaft të numërohet thonë, se u spostua nga një parti te tjetra s'ka asnjë të keqe...

\*\*\*

Me ligjin e spostimit të këtyre gjyqtarëve, u spostua ideali. Ai, i shtetit të së drejtës, atdheu, përkatësia ...

Nderi, guximi, ndërgjegjja... vëmendja!

Me këtë ligj të pashkruar, çdo ditë e më tepër po spostohet për diku tjetër shpresa, ëndrra, e ardhmja!

\*\*\*

Dhe ti ende habitesh lexues i dashur...

Nuk e pe?! Ta tregoi edhe vetë toka në Marinëz, ta tregoi bardhezi.

Shpërtheu, kundër vendimeve të gjykatave.

Ndryshe nga ty, edhe nëntokës iu sos durimi!

Ndryshe prej teje, i tha mjaft nguljes së tubit vertikal, që mandej spostohet horizontalisht deri në qendër të fshatit...

Reagoi toka në Marinëz dhe si për të ta treguar ty, shpërtheu në formën e dy gishtave...

Dy gishtat, që të spostuan në vrimën e fundit të kavallës gjithë këto vite.

Shpërthe, plas, bëhu copa po të duash tashmë!

Nuk është faji i të huajve që ti ende u beson gjyqtarëve të plepave.

E vërteta është se sot, si një mushkonjë mbi kuriz të elefantit përfundove!

Mbete i spostuar si individ, shoqëri e si shtet plot 24 vite për shkak të këtyre gjyqtarëve...

nës së vet.

Lekë Prelë Alija, jetoi në kapërcyellin mes shekujve XIX -XX, i gdhendur në një curr të ashpër të fisit tonë të moçëm. Një homerikë i vjetër, të denjë për këtë emër, rritur në një botë heroike, vizatuar dhe stolisur me mitologjinë e legjendave më të kullurara arbërore, në antipod të plotë me burrat kryekobure, krenarë e ngatërestarë të pandreqshëm, të cilët mbi gjithçka e çdo gjë vlerësonin koburën, lojën më të rrezikshme të "fëmijëve" të armatosur të Evropës.

Kryevojvoda i Shoshit, Lekë Prelë Alia, mori pjesë në luftën e Miletit të zhvilluar në prill 1880, së bashku në mbi 200 vullnetarë dukagjinasi, të cilët qenë vendosur në vijën sulmuese në Nen Helem<sup>2</sup>. Sa herë zëri i atdheut të plagosur ka thirr ndihmë, kjo derë është përgjigjur, siç ka qenë ruajtja e tërësisë tokësore në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa Kryengritjet e Vitit 1910-1911<sup>3</sup>, Lekë Prelë Alia së bashku me Deli Marashin kanë qenë prijësit kryesorë të Krahinës së Shoshit në këto dy beteja që mbajnë vullën e pashlyer të historisë. Jetoi në një jetë të tërë me një emërues e motiv të përbashkët si përfytyrim i frymës së Kanunit, kodit moral e shoqëror të shqiptarit. Një jetë pa përllyer me kujtime të pashlyera shoqërore historike. Kujtimi juaj burrëror le të mbetet një flakërim e memoristik për kush do të njohë historinë e maleve tona!

## VUKSAN LEKA- PATRIOTI QË MORI 101 VITE BURG NGA ZOGU

Vuksan Leka ka qenë një burrë i gjatë me trup të hollë. Gjithmonë acar, në tirq, xhamadan e qyrkun safjani të stolisur me aksesorët më tipikë të petkave tona tradicionale. Bashkëkohësit që e kanë njohur e përshkruajnë si një njeri të thjeshtë në sjellje, i kursyer në fjalë, i vendosur në besimin që ushqente. Vuksan Leka qëndroi larg propotencës, mendjemadhësisë estravagante dhe instiktit të dhunës që karakterizonte jo pak bashkëkohës të tij që gëzonin famën e "burrit të fortë" vetëm se vrisnin njerëz për konflikte personale dhe fitonin lavdinë e "heroit" të mburosur në këngë. Si shërbëtor i bindur i Kanunit, pasaportës së kodit moral e shoqëror të shqiptarëve, pleqnoi fis më fis e bajrak më bajrak me "konarin" e paanësisë sipas parimeve të tij thellësisht dialektike: Larg duart nga ai që predikon moral, e që për vete jeton jashtë çdo morali<sup>4</sup>. Vuksan Leka, në vitin 1910, kur Turqia shpalli konstitucionin, (për të gjitha kombet që kishte nën sundimin e vet) mori pjesë mes krerëve dhe një suite të madhe të Shoshit në manifestimin e madh popullor, që u organizua në Kalanë e Shkodrës<sup>5</sup>! Me 1915 ka qenë njeri nga eksponentët kryesor të Shoshit në luftë kundër malazezëve në Qafën e Boshit. Qe përkrahës i Vidit dhe austriakëve gjatë Luftës së Parë Botërore, si parik numër dy i Shoshit me 1920 pozicionohet hapur në mbrojtje të

2 Hamdi Bushati, "Lufta e Miletit" Shkodra dhe Motet", Shkoder botim i vitit 1999 vëll I, fq. 234.  
3 Hylli i Dritës Vjena XIII "Shkodër Dhjetor 1937, fq 57  
4 Eduart Çiurçija "Flamurtaret e Shoshit nder Breza" Sh.B.Camaj Pipaj viti 2012, fq 47  
5 Zef Harapi "Dukagjini në dokumente historike" AM H.Shkoder.f.174



Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës. Gjatë klimës së paqëndrueshme politike të viteve njëzet, që mbështetës i forcave të Fan Nolit. Në ditët e para të qershorit 1923, së bashku me Babun Celin, Zef Delinë, Mark Milanin, Prekë Sokolin, Pal Mëhillin, Binak Pjetrën dhe disa vullnetarë të tjerë të Shoshit ballafaqohën për 4-5 orë me pushkë me forcat operacionale të Prengë Jakut, që kishin si drejtim lëvizje rrugën Mali Shoshit- Kodër Shen Gjergji<sup>6</sup>. Ka qenë një nga eksponentët parësor të Shoshit në Kuvendin e përgjithshëm popullor në Kodër Shën Gjergji, në vitin 1923, ku u formua një besëlidhje në mbështetje të qeverisë, e cila nga ana e saj nuk do të lejonte të depërtonte në tokën shqiptare asnjë influencë të huaj<sup>7</sup>. Në zgjedhjet vendore të vitit 1923, së bashku me Ndokë Mirashin, Pjetrush Ndojën, Bal Gjonin, Gim Marashin zgjidhen si perfaqësuesit pushteti vendor për Zonën e Shoshit<sup>8</sup>. Vetëm disa muaj më pas mori pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924, në sulmin e armatosur mbi Prefekturën e Shkodrës me datën 31 maj dhe marrjen e qytetit të Lezhës me 8 qershor. Në Kryengritjen e Dukagjinit të vitit 1926 ishte nga eksponentët kryesorë të Shoshit dhe konkretisht në aksionin për marrjen e Qendrës së Rrethit në Kodër Shëngjergji, me 19 nëntor dhe tek Ura e Mesit me 21 nëntor<sup>9</sup>. Vuksan Leka, Mark Milani, Ndokë Mirashi, Gjëlosh Vata për veprimtarinë e tyre në ngjarjet e viteve 1924, 1925, 1926 janë cilësuar nga Camillo Libardi si manipulues dhe intrigantë<sup>10</sup>. Libardi krahas panoramave realiste, në kujtimet e tij, në disa raste nuk i shpëton një pasioni paragykykues që ka për shqiptarët duke e tejkaluar masën, duke i paraqitur si thellësisht të dyzuar, intrigant, dallaverexhi dhe të korruptuar. Krahas fakteve të pashkruara që na servirë për këto ngjarje shumë të debatueshme në arsyetimet e tij, kleriku italian na shfaqet edhe vetë i dyzuar dhe kontradiktor, duke mos pasur një kufi të qartë mes atyre që mendon ai vetë dhe këndvështrimi se si i ka parë e vlerësuar Vatikanin këto ngjarje.

6 A.Q.SH.Fondi 252 dos. nr 4.12.dt.07.06.1923

7 "Hylli i Dritës" viti 1923, Nr 9, Fq.239. Camillo Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu".Sh.B."Naim", Tiranë 2012, fq.27

8 "Ora e maleve" 13.12.1923

9 Camillo Libardi."Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu".Kujtime historike me 1918-1940.f.75. Në këtë mbledhje nga Shoshi kanë qenë të pranishëm Lulash Gjëloshi, Vuksan Leka (Pepsumaj), Ndokë Mirashi, (Pepaj) Pjetrush Ndoja(Ndreaaj).

10 Camillo Libardi."Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu".Kujtime historike me 1918-1940.fq.48

Pas triumfit të legalitetit, Vuksan Leka qëndroi për disa muaj i arratisur në malet e Mollës dhe të Pepsujmave së bashku me Mark Milanin dhe Prekë (Shor) Sokolin. U dorëzuan me ndërmjetësinë dhe dorëzuan Hasan Beg Bushatit, ish-Komandant i Operacionit gjakatar në zonën e Shoshit, i cili i preu në besë duke deklaruar para gjyqit:-Ja ku i keni kriminelët që i zura në male. "Pas gjyqit politik të marsit 1927, u dënua me 101 vjet burg"<sup>11</sup>. Me 24 tetor 1937, në Kodër Shën Gjergji, mori pjesë në Kuvendin e Krerëve të Dukagjinit, më i madhi i tre dekadave të fundit për nga pjesëmarrja e më i rëndësishmi për usullet (vendimet) që mori dhe i fundit në historinë e kuvendeve të tilla të krerëve të Dukagjinit<sup>12</sup>. Në pranverën e vitit 1939, në moshë 65-vjeçare<sup>13</sup>, në mënyrë aksidentale i bije alltia nga shoka e brezit dhe një plumb, që kishte dhjetëshja në grykë, mes një kuvendi pleqtarësh të fisit, ia shkimi jetën.

## LEKË VOJVODA INTELEKTUAL PERËNDIMOR I PLAGOSUR RËNDË NGA POLITIKA.

Lekë Vojvoda ka lindur me 7 maj të vitit 1918, në Pepsujmaja, nga nëna që nipi i Dedë Lulashit të Lotajve të Shalës, bashkëluthtar dhe shok prangash i Mehmet Shpendit. Lekë Vojvoda e filloi gjithçka nga hiçi, u arsimua, fitoi të drejtën e studimit, u laurua si pedagog i përgatitjes së zjarrit në Akademinë e Padovës. I arsimuar më së miri, fliste frëngjisht, anglisht dhe një italisht të shkëlqyeshme; ishte i aftë të debatonte për letërsinë, artin dhe filozofinë. Ka qenë vetëm dhjetë vjeç kur në vitin 1928 regjistrohet në shkollën fillore të Konviktit "Malet Tona". Atë shkollë Vojvoda do ta përfundonte në vitin 1932. Në vitin 1939 vazhdon përsëri studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Modenës, në degën e Kavalerisë. Në vitin 1941 përfundon studimet në Akademinë Ushtarake të Modenës që ishte një nga më prestigjiozot e Italisë dhe po atë vit u diplomua me rezultate të larta në degën e Karabinierisë. Pasi përfundova Akademinë e Modenës (1941), - thotë Vojvoda, në kujtimet e tij, për një vit vazhdova aplikacionin pranë Akademisë së Firences për degën e Karabinierisë. Gjatë kohës që ndiqte studimet në Modena, u regjistrua si student i korespondencës pranë fakultetit të Drejtësisë së Firences, por fatkeqësisht nuk arriti të merrte dot diplomën. Pasi mbaroi aplikacionin njëvjeçar pranë Akademisë së Firences, të gjithë studentët u shpërndanë në reparte të ndryshme të Italisë, ndërsa Lekën e mbajtën aty në Akademi si pedagog ku për një vit dha lëndën e Teorisë së Qitjes.<sup>14</sup>

Me 9 prill 1939 refuzoi betimin fashist, së bashku me Ablyl Këllezin e disa shokë të tjerë. Të nesërmën autoritetet e shkolles e iternuan Abdyl Këllezin, të cilin e konsideruan si organizatorin e gjithë asaj që kishte ndodhur.<sup>15</sup> Duke pasur

11 AQSH,F.1576,V.1927,fleta 9-11.

12 AQSH,F.374V.1937.D,nr 2 fleta 9-1-4

13 Treguar nga Lekë Vojvoda djali i Vuksan Lekës 98 vjeç nga fshati Pepsujmaja Shosh

14 Dashnor Kaloçi, Gazeta Shqiptare e enjte, 19 shtator 2003.

15 Dashnor Kaloçi, Gazeta Shqiptare, 18 shtator 2002.

dëshirën e madhe që të kthehej në Shqipëri, i bën kërkesë Ministrisë përkatëse, e cila ia aprovon dhe në shkurt të vitit 1943 kthehet në atdhe dhe me 14 shkurt të vitit 1943 emërohet në detyrën Komandantit të Xhandarmërisë të rrethit të Lezhës, ku qëndroi vetëm tre muaj. Nga Lezha do të transferohej në të njëjtin funksion në qytetin e Tuzit, detyrë të cilën e ushtroi për 6 muaj, pasi për arsye pune transerohet në detyrën e Komandantit të Xhandarmërisë së Rrethit të Dukagjinit. Gjatë kësaj kohe hyri në lidhje të fshehta me majorin britanik Nils.<sup>16</sup> Lekë Vojvoda ishte dhe mbeti gjithë jetën një zogist i bindur. Si Rrethkomandati i Dukagjinit (kështu quhej në atë kohë Komandanti i Rrethit), Vojvoda ka meritën e padiskutueshme se në kundërshtim me detyrën e tij funksionale për të cilën paguhej, madje mirë, nuk mori asnjë masë ndëshkuese ndaj Qendrës së Lëvizjes Nacionale Çlirimtare që ndodhej legalisht në fshatin e tij Pepsujmaja. Në Rrethin e Dukagjinit shërbeu deri në korrik të vitit 1944, kohë në të cilën dha edhe dorëheqjen përfundimtare nga detyra. Pas çlirimit forcoi lidhjet me majorin Nils, me kolegun major Mark Mala dhe elementët antikomunistë, duke u bërë objekt i organeve të Sigurimit dhe Mbrojtjes Popullore. Me 24 gusht 1946 shefi i Seksionit të Sigurimit të Rrethit të Dukagjinit kishte marrë urdhër për ta shoqëruar për në seksion Lekë Vojvodën dhe bajraktarin e Shoshit, Lulash Gjëloshi. Vojvoda, duke e parandjerë rrezikun e arrestimit që e priste, i rrëshqet Xhemalit të frikshëm nga duart. Pas arratisjes spektakolare të Lekës, u arratisën edhe i vëllai Lulash Vuksani djali i axhës Mëhill Nika dhe meshkujt e tjerë të familjes.

Në këtë kohë, në shenjë hakmarrje nga Xhemal Selimi, iu dogji kullën dykatëshe, stanin, iu konfiskua pasuria dhe të gjithë familja u dergua në internim në Berat. Lekë Vojvoda, së bashku me Lulash Gjëloshin, Bekë Delinë, Major Mark Malën, Mirash Nduen, Lulash Stakën, Gjon Pepën, Sadik Markun, Pal Thanin, Nikë Lushin, Zef Delinë, Çun Delinë, e shumë e shumë të tjerë qëndruan të arratisur deri në tetor të vitit 1946. Lekë Vojvoda qëndroi i arratisur deri në tetor të vitit 1946. Qeveria e Tiranës në këtë muaj shpalli një amnisti të përgjithshme për të gjithë të arratisurit. Në këtë kohë Vojvoda, së bashku me të gjithë të arratisurit, vendosën të dorëzohen, me përjashtim të Bekë Delisë, për të cilin nuk kishte falje. Lekë Vojvoda, pas një viti, në tetor të vitit 1947, doli në gjyq dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie. Të gjithë dënimin prej 7 vitesh e vuajti në kampet e Kavajës e Orman-Pojan. Pas burgut është internuar në Saver të Lushnjës deri në vitin 1984, duke mos iu dhënë kurrë më rasti të ushtronte profesionin e tij të dashur. Jetoi afërsisht një shekull, ndërsa 26 02 2015 u shua nga kjo jetë duke mbetur tetabazin e kujtesës së kohës si një nga ushtaraket më të vjetër, më të talentuar dukagjinasi të gjitha kohërave (akademist i shkollës i Modenës dhe Firences) fisnik dhe mendjendritur si intelektual, shembullor si njeri, hirëplot si paraqitje, i pa fat në karrierë e vrrarë ushtarake dhe politike.

## Pergatite Prele Milani

16 Sipas intervistës së dhënë gazetarit Dashnor Kaloçi për Gazetën Shqiptare, e ejte 19 shtator 2002.

# Një stemë heraldike antike dhe dinjitoze për Shkodrën!

AGRON LUKA

Botimi më i fundit, i sistemit monetar mesjetar dalmatin, të qyteteve të shekullit XIV e XV, ku inkuadrohet edhe Shkodra me monedhat e saj autonome, sinjalizimi i gjetjes së një ekzemplari të një monedhe shkodrane në Drisht, u bënë shtyssa për ta ritrajtuar edhe një herë këtë temë. (shih fotoskanimin 1)

\*\*\*

Me vendosjen e sistemit demokratik, në fund shekullit XX, me parulla e aspirata pro qytetërimit, antarësimit në komunitetin dhe integrimin në Evropë. Ishte e natyrshe që rikthimi tek traditat e heraldikave evropiane do kërkonte një kohë dhe studime sa më objektive e sigurisht edhe diskutime e vendime kolegjiale.

Përzgjedhja stemës heraldike, në kryeqytetin Tiranë përshembull, paraqiste vështirësi, sepse nuk dihej që Tirana kishte pasur histori qytetare. Fillimisht u aprovua, stema e përzgjedhur e demokratëve, që ishte kompleksi, xhamia e Ethem Beut, bashkë me kullën e sahatit. Por, me fitoren e socialistëve, "stema demokrate" u anulua. U propozua një lloj kombinimi e kompromisi, mbetej kulla e sahatit (realisht ish kullë orjentale e restauruar si "stil venecjan"), duke e kombinuar me një tip luani, stemë feudale mesjetare, e gjetur në një varrezë në Lezhë, e fisnikut Anton Skurraj. Me pak paracaktim e fantazi, u ideua edhe "Çelësi i Tiranës", megjithse asnjë dokument ose artefakt antik ose mesjetar nuk provonte një fortesë fushore antike romake ose një fortesë të mesjetës dhe gjithashtu nuk ishte marrë as mundimi për gjurmime arkeologjike! Thuhet se të dyja idetë ishin të Edi Ramës, por ka edhe mundësi që dikush ia këshilloi, sepse në një rast ishte konstatuar se ai nuk kishte njohuri të qarta për historinë e Tiranës e të tjera. Kjo, Stema e Tiranës, na tregonte medemek edhe "orjentimin gjithmonë perendimor", dhe më në veçanti të popullit të Tiranës!

Në rastin e Shkodrës, konkretisht dhe faktikisht problemi paraqiste pak më shumë vështirësi, për shkakun e një ekzistence e vazhdimësie qytetare që shtrihet në tre mijvjeçarë. Një pjesë e ish heraldikave antike kishin humbur, një pjesë ishin përzier e deformuar nga pushtimet e huaja, romake, bizantine, kristiane, sllave e të tjera, për të përfunduar deri tek pushtimi osmano-islam, i cili tentoi t'i fshinte "pa nam e nishan", jo vetëm si praktika e simbole evropiane, por mundësisht edhe t'i zhdukte komplet edhe si objekte arkeologjike idhujtariste.

Konkretisht, Stema e Bashkisë Shkodër, na u gjet çuditërisht e gatshme e analizuar, e tenderizuar dhe e "sajdisur", nga Tirana, nga eksperti korçar, Gjin Varfi! ("Heraldika shqiptare", botim i vitit 2000; po ai "Heraldika shqiptare", revista TEMPULLI, 3, Korçë, 2001, fq. 41-46)

Teoricienët, heraldistët e historianët e PD-së dhe votuesit e Këshillit Bashkiak me shumicë të djathtë "demokrate" e aprovuan ardhjen e gatshme të stemës, nga Tirana, por duke i adoptuar edhe disa

shtesa "shkodrane". Megjithse disa kërkesa për diskutime, nga Këshilli Bashkiak Shkodër, nuk u lejua asnjëherë asnjë lloj diskutimi e pjesmarrje diskutuese publike edhe kur me ndonjë rast ishte kërkuar një diskutim me firmat e disa nga intelektualët më të shquar të Shkodrës!

Kështu, dijelerët e gjithëdijshëm demokratë i ranë hasha të gjithë traditës shkodrane, ku nuk mungonte as "Çelësi i Shkodrës"... Realisht kjo stema e Shkodrës, ishte gatuar ideologjikisht, teoriki-



Fig.1. Monedhë bakri mesjetare e Shkodrës njaft e dëmtuar nga koha




Fig.2. "Stema heraldike" e Shkodrës, e propozuar nga G. Valentini, më 1939; Stema e Bashkisë Shkodër e transformuar simbas heraldistëve demokratë; Stema e Bashkisë, aktualisht mozaik përpara ish Prefekturës, adoptuar si Bashki



Fig.3. Monedhë e Stefan Uroshit V (1355-1371) me Shën Stefanin



Fig.4. Monedha të Shkodrës autonome me Shën Stefanin, protomartir, Pajtori-Protetori i Shkodrës dhe Stema

sht dhe me një lloj mbrapavije, qysh nga koha e pushtimit fashist italian. Numizmatit e medievisti prifti katolik italian G. Valentini, i shqiptarizuar e shkodranizuar si Zef Valentini, kishte pretenduar aso kohe edhe zbulimin e Stemës Heraldike të Qytetit të Shkodrës. (Revista "LEKA", nr. 4, 1939, "Numismatika Saveriane"). Simbas, Valentinit, Stema ishte nxjerrë nga numismatika kris-

tiane mesjetare e fund shekullit XIV, nga një monedhë, e cila kishte dy yje të Davidit, herë me një S, e herë diku edhe dy S (STEFANVS SCVTARENS) e të tjera. Shën Stefani/Shtjefni protomartiri i parë, ishte Pajtori - Protektori i qytetit të Shkodrës.

"Stema Bashkiake" e fund shekullit XX, me disa ndryshime, improvizime dhe kompromise, si bie fjala ndryshimi i yjeve nga me 6 cepa në 8 cepa, u vendos fillimisht tek ish Bashkia/ish Beledia otomane. Stema e re, ishte një vizatim shqyti, mbi një kompensatë me ngjyrat kuq e blu të K.S. Vllaznia! Më pas, u ba një farë "rinovim-modernizimi", mbi sfungjer me po ato ngjyra, duke improvizuar me atë rast edhe një flamur bashkiak, të pa ekzistuar kurrë!

Ma në fund me rrokadën e këmbimit të ndërtesave Prefekturë – Bashki (kur medemek pretendohej ruajtja e rikthimi në identitet!) dhe me shtrimin e Piacës me pllaka mali e gurë Zall Kiri nga një "Firmë", stema simbas ideve të një "projektuesi", është "përrjetësuar" para ndërtesës së ish Prefekturës, edhe si mozaik! (fig. 2)

\*\*\*

Ne, po paraqesim këtu vetëm një vështrim sipërfaqësor, nga monedhat autonome të Shkodrës, të shekullit XIV e XV, pastaj edhe të disa nga monedhat e feudalëve Balshiç, nga Balsha II, Gjergj Strazimir Balsha dhe Balsha III dhe në fund edhe disa monedha kur futet edhe protektorati venedikas, mbas vitit 1396.

Mbas vdekjes së Carit dhe Kralit, Stefan Dushani Uroshi IV (në mbretërim 1331-1355), më 1355, me përçarjen dhe tatëpjetjen e Serbisë mesjetare, titullin e Carit/Perandorit e mori Stefan Uroshi V, ndërsa atë të Kralit/Rex e mori Vukashin Mërciançeviç. Një nga monedhat e paraqet Carin Stefan Uroshi V (1355-1371), djalin e të njohurit si Stefan Dushani.

Në fundin e shekullit XIV, gjejmë një monedhë të Shkodrës autonome, është një folar me inicialet S STE FANE dhe ana tjetër C: SCUTARIN – ENSIS. (Fig.3) Nuk ka asnjë dyshim se, germa S lidhet me Shën Stefanin Protomartir, Pajtorin e Qytetit dhe kishën katedrale në Kështjellë. Del se nga kjo shtampë ka disa tipe e prerje me ndryshime, siç e kishte konstatuar edhe Valentini. Shën Stefani do të ruhet edhe në monedhat e feudalëve Balshiç edhe kur ato bien nën protektoratin apo vasalitetin osman, dhe do të ruhet edhe nën protektoratin venedikas. (Fig. 4, 5, 6)

Bie në sy se, analizimet e "specialistëve" e numizmatëve e heraldistëve shqiptar të mbas 1944 e të mbas demokracisë, janë gjysmake, shpesh edhe me interpretime e subjektivizma tendencioze, madje pa pasur në dorë fare as ekzemplarë të gjetjeve tona arkeologjike! Askush nuk e ka marrë mundimin ta studiojë e ta sqarojë komplet ikonën e saktë dhe simbolikën e Stemës, nga vjen, çfarë përfaqëson, kjo mburoja/shqyti, ku ishin shtampuar e të tjera! Po ashtu të paqarta mbeten edhe ikonat e simbolikat me ujë të Balshiçëve, mbetet e papërcaktuar përkatësia etnike e tyre, si origjinë e si natyralizim biotnik, si titullatura, si bilinguizëm e të tjera.

Në studimet e analizat historike, mungonte e mungon komplet prezenca, ekzis-

tenca dhe analiza e borgjezisë merkantiliste qytetare republikane të Shkodrës dhe e shtresave proletare. Analizimi i epokës së



Fig.5. Monedha me Shën Stefan dhe me Stema e simbole heraldike të dinasti families feudale Balshiç



Fig.6. Monedha me Shën Stefanin dhe me luanin venedikas të fund shekullit XIV e XV



Fig.7. Tritoni/delfini dhe tërfurku i Poseidonit antik, i "robëruar" nën gurë e betonimet anarkiste



Fig.8. a) Terrakotë e artit arkaik e mijvjeçarit I-II p.e.r. e zbuluar në Shkodër: "Fatia me fëmijë për gjurit" e murosur e sakrifikuar. Publikuar dhe komentuar nga ne, në një emision televiziv lokal; b) Terrakotë, "nana me fëmijë" e gjetur në Tanagra (Graena) Greqi e shek IV-V p.e.r.

# Gjithëçka duhet të dini për VAKSINIMIN

**Tërhiqet vëmendja se mbulimi është akoma i pa mjaftueshëm në të rriturit.**

Përsa i takon vaksinimit, kudo në botë ka pro dhe kundra. Por, një gjë është e sigurtë, po të mos ishte vaksinimi- *Difteria (hard-huca)*: ose *Polio-myeliti* (paraliza infantile e femive)nuk do të ishin zhdukur dhe Variola (lija) nuk do të çfarosej nga planeti. Vaksinimi nuk është një mjet, që mbron në mënyrë individuale kundër sëmundjeve infektive (ngjitjes). Ai lejon të luftohet në mënyrë kolektive (masive) kundër përhapjes në të afërm, kur ato nuk janë të mbrojtura.

**Me vaksinat, sistemi ynë imunitar-mbrojtës nuk është shumë tërheqës.**

Vaksinimi konsiston në futjen në organizëm të një antigeni d.m.th të një lëndë të huaj, që provokon një mbajtje (imunitet) kundër sëmundjes pa e provokuar atë. Vaksinimi nuk prish reaksionin e sistemit imunitar-mbrojtës i cili ka mundësi të përgjigjet në mënyrë simultante (të njëkohshme) mijëra antigeneve. P.sh : i posalindurve ka mundësi sipas studiuësve të përgjigjet ndaj 10000 (dhjetë mijë) antigenëve njëherazi, kështu po që së përdoren 10 (dhjetë) vakcina për një herësh mobilizohet vetëm 0,1 % e sistemit imunitar.

**Tani si zgjidhet problemi i kacerit në qafën e mitrës (ca. coli uteri)?**

Vaksinimi kundër Haman papiloma Virus (HPV)nga i cili e ka prejardhjen plotësisht kanceri i qafës së mitrës tek femrat, rekomandohet për të gjitha vajzat e reja që nga moshën 14 vjeçe në njërin prej vaksinave që janë në treg farmaceutik (Gardasil-R ose Cervarix-R). duhet të dihet se të tre injeksionet vakcinuese janë të kontrolluara dhe gjykohen të rëndësishme. Deri tani në vendin tonë bëhet në mënyrë selektive tek gratë e rezikuara, që e kërkojnë dhe akoma nuk ka një ndërmarrje për tu bërë masivisht dhe të rimbursohet nga shteti,sido që kjo nuk po kryhet akoma,as për vaksinën e gripit.

**Për dijeni : i gjithë grupi i vaksinave është tre llojesh:**

a)Vaksina,që rrjedhin nga viruse ose toksina jo aktive si gripi, hepatiti, tetanozi, difteria.....

b)Vaksina, që e kanë prejardhjen nga agjent infektiv të gjallë: por të dobësuar (fruth, parotit, rubeola, ethe e verdha, varicela etj.....

c)Vaksina sintetike, që vijnë nga gjene të hepatit "B", të Papiloma virus human....

**Përse rezervohet Pneumokoku**

Indikacionet e vaksinës kundër Pneumokok që shkakton Pneumoni, septiceni dhe meningiti kufizohen për personat e dobët, fraxhil, që rrezikohen për infeksione të rënda si tek pneumopatet, te semuret me sëmundje cardio – vaskulare ose tek ato me frenim të forcave mbrojtëse (imundepresivet) si dhe tek duhanpërsit dhe alkoolistet e pa frenuar.

**Kunder kolles se mire deri ne cilen moshë mund te vaksinohen fëmijët?**

Krahs vaksinimit që behet sipas kalendarit të vaksinimit ne moshat e vogla nje rikujtim vaksinimi rekomandohet ne shume vende midis moshes 26 -28 vjeç dhe kjo mund te behet i per difterine, tetanozin, pertusin dhe poliomyelitin, pra theksojme se mund te merret tek te gjithe adultet qe kane dhjete (10) vjet pa i bere nje rikujtim me vakcina dhe sidomos çiftet që dëshirojnë një fëmijë, koji nga praktika,se bebet që kanë kaluar pertus të rëndë ishin infektuar nga prindërit e tyre. Të afërmit e shtatzënë duhet të vaksinohen gjatë kohës që ajo është shtatzënë dhe ajo vetë po që se nuk është vaksinuar përpara barrës,vaksinohet pas lindjes së fëmijës.

**A duhet të rriturit të vaksinohen kundër varicelës (Lisë së qenit)?**

Kjo vaksinë duhet të bëhet në rastet të përcaktuara,kur janë të pa imunizuar, ato që janë në kontakt të ngushtë me imunosupresivët,për gratë që janë në moshë produktive ose kur dëshirojnë të kenë një fëmijë dhe kur janë në kontakt me të sëmurë të tillë. Në rastin e kontaktit vakcina duhet të bëhet brenda tre ditëve,që përvijojnë kontaktin,paqjetër pa u sëmurur akoma.

**Përse po përgjithsohet në shumë vende vaksinimi kundër Meningokokut?**

Në se kemi raste nga menungokoku "C", që është rraltivisht i rrallë: por me pasoja dramatike:që mund të shkarkojnë vdekje brenda disa orësh ose që len sekela (pasoja)

neurologjike të pa kthyshe. Në këto rethana në 2010 në disa vende të Europës përfshi dhe Francën është bërë vaksinim sistemik në gjithë fëmijët 1-2, që përfshihen deri në 24 vjeç.

**A paraqet ndonjë rrezik vakcina kundër Hepatit "B"?**

Është dyshuar se ka një kontribut në zhvillimin e "sklerosës desiminata"në vitin 90, por është çfajësuar nga shumë studime shkencore. Virusi i Hepatit transmetohet me anë të gjakut,mardhënjeve seksuale dhe në kohën e lindjes,prek melçin duke shkaktuar cihosis dhe kancer të melçisë.

Po ashtu këto vitet e fundit përsëri është akuzuar vakcina MMR (Fruth-Parotit- Rubeole)për Autizëm tek fëmijët,por deri tani nuk ka asnjë konfirmim pëveç koincidencës së vendosjes së diagnostikimit me afatin kur aplikohet kjo vaksinë.

**Për të ulur dhimbjen e injeksionit të vaksinës a mund të bëhet anestezi lokale?**

Tek disa fëmijë të ndjeshëm me ngashërim, në disa vende mund të ulet ndjeshmëria e lëkurës me një leukoplast me analgjezik (patch Emla-R) i cili vihet 1 orë para injeksionit të vaksinës: por kjo nuk duhet të përdoret në vaksinën BCG (kundër tuberkolozit), pasi mund të ketë pasoja në efikasitetin.

**A shkakton rreziqe vaksinimi?**

Në përgjithësi vaksinat janë të sigurta,por patjetër mund të ketë dhe efekte ansore (sekondare),sido që ato janë të kufizuara (ethe,dhimbje në vendin e çpimit).

Reaksionet e pa dëshirura më të rënda janë një përjashtim: por ndodhin nga 1/1000 deri në 1/1.000.000 doza.

**A ka kundërndikime formale për vaksinim ?**

Rastet kur nuk lejohet të bëhet vaksinimi (pra që kundërndikohen) janë të ralla dhe lidhen shpesh me një alergji të rëndë ndaj një përbërsi të vaksinës si në ratin e alergjis nga veza,që nuk lejohet të aplikohet vakcina kundër gripit ose etheve të verdha.Mund të ketë dhe ndalim (kundërndikim) për një kohë të caktuar si në : ethe; infeksione në afatin e vaksinës,exema infatum e rëndë (rjebulla)

e së fundi përdorimi i vaksinave të gjalla me mikrobe të dobësuar të ndalohet në personat me frenim të imunitetit (mbrojtjes) dhe në shtatzënat.

**Përse disa vakcina nuk janë të detyrueshme?**

Vetëm disa vakcina janë të detyrueshme që në lindje: kundra tuberkulozit, verdhezës (hepatit B), poliomyelitit dhe që nga moshën 2 (dy) muaj në vijim periodik sipas kalendarit të tre valentës (DTP-Diftero-Tetano-Pretusike) dhe të tjera sipas kalendarit si MMR (FRP-Fruth-Rubeole-Parotit),të cilat nuk duhet të nënvlersohen se nuk janë më pak të dobishme.

**Cilat janë vaksinat më të rëndësishme të rriturit?**

Rikujtimi kundër Difteris,Tetanozit e poliomyelitit 10 vjet pas dozës së fundit dhe po ashtu vaksinimi kundër Gripit tek të moshuari mbi 65 vjeç dhe në të sëmurët që vuajnë nga sëmundje kronike si të mushkërive,zemrës,diabet dhe me rënjë të imunitetit-mbrojtës (imunodefici). Për të pa vaksinuarit këshillohet vaksinim me MMR (Fruth-rubeole-parotit) tek nën 31 vjeç dhe po ashtu kundër kollës së mirë (pretusit) kur ka mbi 10 vjet pa e aplikuar si repel (rikujtim) sidomos tek ato çiftet që kërkojnë të kenë një fëmijë në të ardhmen ose ato që do të jenë në kontakt me posalindur.

**Ka shumë pyetje përse ka shtesa në vakcina?**

Shtesat behen për të amplifikuar (shtuar) përgjigjen imunitare-mbrojtëse të organizmit,pra forcojnë efikasitetin e disa vaksinave si Pertus,Hepatit "B". Në vaksinën e griptit ka shtesë me Skualen (ndërmjësues në sintezën e kolesterolit,të steroideve dhe vit.D) që lejon të ulet doza e lëndës aktive dhe numri i injeksioneve;ndërsa shtesa me Alumin është objekt diskutimi si përgjegjës për sëmundje të rënda si : Syndromi Guillain-Barre-Landry etj, të cilat nuk kanë mundur të provohen.

**Përgatitu:**

**Dr.Med.Ndue NIKAJ**

feudalëve të fundit Balshiq, paraqitet me të meta serioze, sidomos nuk analizohen luhatiet dhe aleanca e tyre me okupatorët turko-osmanë, përfshirë edhe rënia e tyre nën vasalitetin haraçpagues e të detyrimit të haremit! E gjithë periudha jepet në dritë të shtrembër, konformë me rezultatet e diktuar të shkencës enveriste, ku, "pushtimi regresiv venedikas barazohet me atë regresiv osman, në mos edhe më keq!"

E ashtuquajtura "toleranca fetare model" dhe mosdakortësia e disa teologëve e sigurisht edhe e disa politikanëve ngatërruar, u pa e qartë me problemin, që "pa dashje" e hapi ambasada e SHBA. Kjo ambasada, kishte akorduar një lloj projekt-fondi krejtësisht modest, për të restauruar e kthyer në identitet, Kishën e Shën Stefanit/Shtjefnit Protomartir, Pajtor / Protektor i Qytetit. Reagimi dhe mosaprovimi nga kleri islam që i menjëhershëm: Ish kisha katedrale duhet të mbesë si Xhamia e Halifit Sulltan Mehmetit II, Fatih, Botëpushtuesit, meqënëse objekti qysh nga viti 1479, ishte kthyer me Tapi, si "pronësi" e bashkësisë islame, si vend i shenjtë, e të tjera!

Pyesim, përse Shkodra duhet të ketë një Stemë e simbolikë, të lidhur me shenjtorin protomartirin kristian Shën Stefanin? Po t'i referohemi analizës së albanologut



Fig. 9. a-b) Stema mesjetare të shekullit XI-XII, me shqiponjë biqefale të zezë dhe luan, të familjes Shkodrane Lule Frangu. c) Stema heraldike e Komunës Qytetare Republikane të Shkodrës e fundit shek XIV e shek XV, me shqiponjë të zezë me luanin me çelësin në gojë

të shquar J. G. Hahn, ai e pohon qartë se, kristianizmi zgjodhi disa simbolika e shenjtorë fetarë kristiane konkretisht për të mbuluar e varrosur me harresë simbolet e lashta të kulteve ilire. Edhe e ashtuquajtura lojë fjalësh se, Shën Shtjefni nuk na qenka identik me shenjtorin Shën Stefanin protomartirin, që kishin edhe sllavët, nuk qëndron.

Ne personalisht, kishim propozuar që objekti i cili ndodhet në lartësinë dominuese në akropol, në përputhje me legjislacionin laik aktual dhe pronësinë shtetërore, mbas kërkimeve arkeologjike deri në steril, të restaurohej e të shndërro-



Fig.10. Stema antike ilire e "ΣΚΟΔΡΗΝΩΝ" me anijen labiatane e të tjera

hej në një pavion muzeumi shtetëror, ku të pasqyrohet komplet vetë historia e atij objekti. Restaurimi, ruajtja e formës muzeale së kishë-xhamisë e të tjera, natyrisht ishin çështje të specialistëve. Po ashtu qendra moderne e Shkodrës ka se çfarë të vendosë si figura më gjithpërfaqësuese, historike e të tjera. Përse shijet e imponimet e "demokratëve", na qenkan kaq të pa diskutueshme, aq sa mos të lejohet as diskutimi?!

Në Shkodër, siç edhe në gjithë Albaninë mesjetare, ishte zhvilluar një nga betejat më të mëdha të shekullit XV. Aso kohe, kishte plot përpjekje për ta kanalizuar

luftën e rezistencën heroike mbrojtëse nacionale, në funksion të projekteve për Kryqëzata e Islamizata fodulle mesjetare. Epoka e këtyre luftërave të përgjakshme e shkapetieve frontale të këtyre pllakave tektonike feudale fetare, ndoshta u mbyll me një lodhje të të gjitha palëve, pikërisht në Albani. Me zbulimin e kontinentit amerikan, me rrugët e reja detare gjeografikotregëtare, Evropa e bota njohën zhvillime të reja.

Shpresojmë se me dominimin real të standarteve e mentaliteteve moderne, me fitoren e forcave moderne progresiste, do të nevojitet që të hapet ky diskutimi i Stemës dhe i disa përmendoreve në qendrat e qytetit, në vend të atyre surrogatëve që kanë improvizuar demokratët duke imituar "revolucionarizmat" e komunizmit enverist. Nuk i takon dhe nuk është në nderin e Shkodrës qytetare, të komandohet e të imponohet nga mentaliteti i pseudo intelektualëve!

Shkodra, ka pasur plot simbole të autoktonitetit e të identitetit të saj evropoid, kemi motrën dhe maman e flijueme Fatije, pastaj dominon simboli i shkruari i kryeqendës Ilyriane, "ΣΚΟΔΡΗΝΩΝ", qyteti ka disa stema heraldike mesjetare dhe qytetare republikane, kemi Marin Barletin, rilindas evropian etj! (Fig. 7, 8, 9, 10...)

## Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare

### EDHE NJË KRISËM TJETËR

Një krisëm tjetër  
Mori në qafë një jetë

Tejet të lartin.  
Mos e lëndo o burrë:  
Sot në këto vende  
Është dita e luleve.

Kur ato shpërthejnë,  
Me flatra të bardhë.

Motivi i krismës së vjetër  
Në thepin e pushkës,  
Këputi fillin e jetës.

Në çastin që lindi dita.  
Namin e saj, e gjykoftë KRIJUESI...

### O PERENDI, KU JE!

Ende ndër bjeshkët e nemuna,  
Nuk soset dita e sertë . . .

Vendi në vend nu e le.  
Se tufa e deleve,  
Sonte ulet ne mort.

Te stani i çobanit,  
Është shkruar jeta.

Diku pas mureve,  
Zgërdhihen gëzhojat e vjetra.

Ku ndalet hakmarrja,  
Te i pafajshmi.

Ndaj protestojnë zemrat . . .  
O perendi ku je?!  
"Një djalosh është më pak"!

### EH, MOJ NËNA IME

Dashuria e saj.  
Një frymëmarrje e re.  
Lind në tokën e të parëve,  
Jeta e gjallë!

Në rrëzë të malit  
Një vend krejt ndryshe.  
Ku zgaqet pranvera  
Me dallëndyshe . . .

Rrotull me kapuça të bardhë,  
Mbi sy  
Ulet në gjunjë malësorja,  
Puth faqet e pafajshme.

Ja pra o nëna ime,  
Edhe kjo ditë e shpallur keq.  
Lindi e larë me gjak.

Atdheu i mallkuar o nënë.  
Presin të madhin gjeneral...!

Lazër Preka

### MEDITIM PËR ADEM JASHARIN

*Baladë, me rastin e 17 vjetorit të rënies*

Sa vështirë e paskam  
Bacë, për ty poemën  
Ti "shkrove" me pushkë  
Unë "pushkë" kam penën

Vallë ç'farë mendoje  
Në at' Mars plot ngricë  
A mos vallë Flamurin  
Ngritur mbi Drenicë?

Se ç'ma ndeze zemrën  
Nuk di pse mendova...  
Në atë kullë – kështjellë  
Mbledhur gjithë Kosova...!

Eh... kjo kulla jote  
Ndërtuar me gurë...  
Në themel plot zemra  
Zemrat gjithë - Flamur!

Kjo kështjellë barot  
Nuk është si e Mujës  
Tre herë e rrethuar  
Si kështjellë e Krujës!

Jashtë, përmbi mure  
Me plumb gdhëndet guri  
Tash lufton kështjella  
Lufton dhe Flamuri!

Ndalet për pak çaste  
Ndalet historia  
Dridhet universi  
Nën peshën e tija

Dikur dhe ka ndodhur  
Veç . . . shekuj më parë  
Kur lufton kështjella  
Vetë në vijë të parë.

Brënda një fortese  
Tre ditë epopë  
Çjerr faqet Europa  
Se do... kabare

Si u ndjeve Bacë  
Kur e pé të vrarë...  
Në fortesën tënde  
Dëshmorin e parë?!

Ky vend i shqiponjës  
S'ka dëshmorë të parë  
Nuk ka as të fundit...  
Ndaj dhe jemi gjallë!

Flakë e zjarr e ndez  
Dushman, bir i bushtrës!  
Unë jam prej Prekazi  
Flas me gryk' të pushkës...!

Flakë do marrë Kosova...  
Një herë kemi lé...  
Unë jam shqipe mali  
Ti korb për Atdhë...!

Do të shkull prej toke  
Shkja... - të humbë soja  
Për liri - mbjell arat  
Me plumb e gëzhoja!

Je një farë e keqe  
S'bën për Dardaninë  
Dhe në tokën tënde  
Je mort për Serbinë!

Ndaj shporru prej meje  
Në shpirt kam Lirinë  
Atë s'mund ta vrasësh  
Është për Shqipërinë!

Ylli Meçe



### VARGJE PER THETHIN DHE KOLEGUN TIM GJOVALIN SHYTI

1. O Alpet e Shqipërisë  
Me dorë kush ju ka qëndisë  
Natyra e bukur, e freskët  
S'ngopesh duke parë Bjeshkët  
Me malet që të rrinë kurorë  
Si nusët hedhur duvakët  
Me gryka dhe shtigje mes malesh  
Rrugët që nga Romaket.  
Eh, moj luginë e Thethit  
Klima që s'ka nevojë për hapje  
Era e luleve, era e gjethit  
O krenari e Atdheut në alpe.  
Në dimër hell vallon e bardhë  
Në verë jeshilon lugina  
Në gjë si nuse të mbajnë  
Jezerca dhe Radohina.  
Mali i Jezercës, lugina e Thethit  
Përmes malesh, përmes shpatesh  
Krenaria e Bjeshkëve Shqiptare  
Oreksin botës ç'i hape.

2. Në Poro në Hoxharë, fushës Myzeqesë  
E ku nuk shërbeve ti orë Bukurosh  
Por era e maleve ku kishe lerë  
Të bëri për vete atje në Tarabosh.

Rrugët, ku derdhën djersën shokët tonë  
Kur shpërthenin male, shkëmbinj, tërë damar  
Ata që prishen gjumin e thellë në male  
Në Theth, në Shalë, Vermosh a Tamarë.

Nga Rrënësi në Koplik, Malësi e Mbishkodrës  
Front dhe prapavijë i kishe të pandarë  
Përshkoje rrugët e Atdheut tim  
Gjithnjë në mbrojtje, në vijë të parë.

MALIQ VREKAJ, Kolonel në pension

### LIQENIT TË SHKODRËS

Moj natyrë sa bujare je  
të mira e begati ke krijuar mbi dhe .  
Krijove rruzullin e gjithsinë  
dhe mbi të gjitha krijove njerinë .

Për të krijove në shekuj të mira plot  
që ai ti gëzojë për jetë e mot.  
Kështu dhe Shkodrën ti nuk e harrove  
një thesar të madh asaj i dhurove.

Një liqen të kaltër tanë madhështi  
që me qiellin puqet tej në pafundsi,

Që Shkodrës i jep fresk, rreze e dritë  
e deri në kupë të qiellit e bën me shndritë.

Madhështor gjithmonë qëndron  
me valë të kaltra Shkodrën ledhaton.  
Me atë madhështi e bukuri  
frymëzon e kënaqë çdo njeri.

Në analet e historisë ti mbetesh për jetë  
njerzve vetëm të mira u ofron në jetë,  
nga visaret që mban në gjirin tënd  
begati e mirëqenje atyne iu afron.

Për të mirat që çdo ditë u ke dhurue  
brez pas brezi shumë të kanë bekuë.  
U jep shëndet e i përtërin  
sa dhe plakut ia kthen rininë .

Vend nderi o liqe ti ke në histori  
ua hape rrugën trimave në luftën për liri

Për njato toka që na i lanë të parët  
dhanë jetën gjyshat tanë e baballarët.  
Se një amanet të parët na kanë lanë ,  
ma parë me dhanë jetën e mandej gjanë.

Me madhështi prite Oso Kukën me trimat e tij  
që me mrojt Atdheun luftuan me trimni .  
Që fli u banë n' Vraninë . në kullë të barotit  
si bij të Shkodërloces e nipa të Kastriotit .

Por ti liqe për ditë të mira na afron  
shumë treva shqiptare i bashkon.  
Që historia mbas dore i pat lanë  
e nëpërmjet teje do të vllaznohen të tanë .

Por trashigimtarët tuaj duhet të mendojnë  
këtë perlë të natyrës ma shumë ta zbukuro-  
jnë .  
Që të rrisin vlerat se e ardhmja të prët  
për njerzit, për kënaqësi, turizëm e shëndet.

Për të gjitha llojet e sporteve ujore  
deri tash te ti liqe janë lanë pas dore .  
Disa të pa ndërgjegjshëm janë tuj të damtue  
që nga të mirat e tua ata me përfitue.

Dhe ndal ti themi ksaj dore vrastare  
që për një grusht të hollash s'kanë turp as  
marre  
Dhe t'zgjojmë kënaqësi të tjera, të reja pa-  
fund  
që si n' liqe t'Shkodrës si gjen askund .

Emri lart liqe një ditë ka me tu ngritë  
Shumë vendas e turist të huaj ke me pritë .  
Kënaqësi të pafund ke me ju afrue  
sa në jetë të jetës s' kanë për t' harrue

Vila e pallate rreth teje kanë me u ngritë  
si perlë e vërtetë liqe ke për të shndritë  
Shpejt atëherë të huajt kanë me investue  
plane rregulluese rreth teje kanë me u zbatue

Ditë ma të bukura shpejt do të vinë  
për ty Liqe i Shkodrës si për gjithë Shqipërinë  
Atëherë më shumë të rinjë do të këndojnë:  
"Në Liqe të Shkodrës eni të lundrojmë  
me të bukurat vajza jetën ne ta shkojmë"

HAKI TEMALI, veteran

### REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi  
Botimin:  
**NDUE FTONI**

